**Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit-** pasi përshëndeti të pranishmit tha se kërkesa e saj e parë ka të bëj me çështjen e bursave, pra që, përveç bursave të cilat u ndahen studentëve të dalluar në bazë të suksesit, të ndahen edhe bursa sociale për studentët e kësaj kategorie. Me një fjalë, do të dëshiroja që të ndahen bursa për studentët që kanë vështirësi financiare, kriza financiare. Për fat të keq, shumë prej studentëve që mund të përfitojnë më shumë nga arsimi i lartë, gjithnjë e më shumë po e kanë të vështirë ta përballojnë shkollimin për shkak të kostove të larta që ndikojnë te secila familje. Shumë prej nesh jemi përballur me sfida të tilla, vetëm e vetëm për të arritur këtu ku jemi sot a ku do të jemi në të ardhmen. Me këtë kërkesë timen duhet ta mbush boshllëkun e këtyre studentëve, sepse këto bursa do të kenë një ndikim të madh, do të jenë një ndihmesë e madhe për studentët në rrugën e tyre drejt realizimit të studimeve të tyre. Kjo nismë do të jetë mjaft inkurajuese e lehtësuese për ta, e parealizuar më parë, që shpresoj ta gjejë përkrahjen e të gjithëve në zbatim. Dita-ditës shohim se rrugët janë të mbushura me qen endacakë. Pikërisht, kërkesa ime e dytë ka të bëjë me këtë çështje, sepse bredhja e tyre rrugëve rrezikon qytetarët. Andaj, duke parë rrezikshmërinë që mund ta shkaktojnë, kërkoj nga ju që ta shtoni fondin për financim për trajtimin e qenve endacakë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**parashtrojë kërkesat e fshatit Pasomë të evidentuara përmes një peticioni: me anë të këtij peticioni fshatarët e fshatit Pasomë gjegjësisht lagjja Dauti të cilët janë fshatarë ,të cilët janë fshatar te përhershëm te këtij fshati dhe tani jetojnë ne fshat mirëpo kushtet e infrastrukturës rrugore janë aq te vështira aq qe vjen ne pyetje edhe qëndrimi i tyre ne fshat, këtij fakti i paraprijnë edhe gurëthyesit qe janë te shume dhe nuk kanë kurrfarë planifikimi dhe strukture te funksionimit, kështu që jeta në këtë fshat është e paqëndrueshme nga pluhuri, zhurma si dhe kohet edhe uji nga puset e fshatit ka filluar te kontaminohet nga materiet, nga eksplodimet qe bëhen gjate shfrytëzimit te këtyre gurëthyesve. Ne fshataret e bëjmë këtë peticion organit kompetent për shqyrtimin e kushteve te jetesës ne këtë fshat dhe i lumet titullit qe segmenti rrugor nga gurëthyesi te asfaltohet deri ne dalje te fshatit konkretisht te lagjes Dauti, me këtë na dilni ne ndihme sado pak mënjanohet pluhuri dhe sado pak krijohen kushte për jetës normale dhe në një mënyrë fshataret do të mbesin ne fshat dhe do te jetojnë jetën e tyre si me pare. Shpresojmë që këto kërkesa të realizohen, duke u futur në buxhetin e komunës për vitin 2023 rruga në lagjen Dauti në fshatin Pasomë.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**rikujtoj dhe potencoj se vitin e kaluar subjektit politik PDK në Vushtrri nuk e kishte votuar buxhetin e komunës dhe mu për këtë komuna sot po i vuan pasojat, andaj ka indikacioni se Komuna e Vushtrrisë këtë vit nuk do të mund as 50 % të buxhetit ta realizoj, suficiti për këtë vit do të jetë shumë i madh. Më tej njoftoj se e ka ftuar kryetari i komunës në takim por ftesa i kishte arritur me vonesë, sido që të jetë grupi i LDK-së gjithherë do të jetë pro buxhetit të komunës për interesin e përgjithshëm qytetar dhe le ta vlerëson qytetari secilin që punon në in tresë të përgjithshëm.
**Faton Hyseni, anëtari i kuvendit-** paraqiti kërkesë për inkorporomini në buxhetin e komunës rrugën "Ilaz Feka" në Karaçë të bëhet shpronësimi dhe zgjerimi i rrugës e cila parqet rrezik për qytetarët që qarkullojë në atë rrugë. Si dhe të rritet numri i bursave në kudër të buxhetit, edhe për nivelin master.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**parashtroj disa kërkesa: në fshatin Novolan asfaltimi i rr. "Bislim Vatovci" me gjatësi rreth 300 metra, në fshatin Vilanc asfaltimi i rrugës "Migjeni" në fshatin Stanoc i Epërm rrugët: "Vjena", rr."Kadri Haradinaj", rr. Tek "Faik Pronaj", rruga tek "Bislim Pronaj", rruga tek "Shefqet Haradinaj", rruga tek "Naser Haradinaj", rruga tek "Daim Haradinaj" "Feim Haradinaj", rruga tek "Ajet Cakaj", rruga tek "Haredin Krasniqi". Në fshatin Maxhunaj të inkorporohet rruga "Drita", në fshatin Mihaliq rruga "Bashkim Kombëtar". Në Vushtrri të inkorporohet rruga "Tefik Krasniqi". Në fshatin Gracë të përfshihet rrjeti i ujësjellësit si dhe të përfshihen ndërtimi i tri rrugëve në këtë fshatë.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**pasi e përgëzoj kryetarin e komunës për ndryshimet nëpër drejtoritë komunale, shtoj se tek DSHP-ja janë planifikuar 462,000.00 € për asfaltim të rrugëve në rajonin e zonës perëndimore të komunës, ndërsa në anë lindore të komunës përkatësisht nga fshati Samadrexhë deri tek Maxhunaj janë paraparë vetëm 33,000.00 €, kjo është një shpërndarje jo e drejt dhe jo e balancuar e buxhetit të komunës.
**Faketet Dushi, anëtare e kuvendit-**kërkoj të sigurohet transporti në fshatin Duboc, posaçërisht për lehtësimin e udhëtimit për nxënësit nga ky fshatë për në qytetin e Vushtrrisë.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**pyeti se përse në draftin final të buxhetit nuk është i paraparë projektit për ndërtimin e tribunave në stadiumin e futbollit "Ferki Aliu".
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-** vlerësoi se investimet nuk drejtohen në bazë të madhësisë së fshatrave por sipas nevojave të qytetareve, sipas kërkesave nga dëgjimet buxhetore, por edhe nga

propozimet e deputeteve. Zhvillimi i qytetit nuk fillon me buxhetin e vitit 2023, gjithmonë janë ndarë buxhete dhe asnjëherë nuk kemi mundur qe t'i plotësojmë të gjitha kërkesat e të gjitha vendbanimeve por çdoherë jemi munduar që ndarja e buxhetit të jete në mënyrë proporcionale sipas nevojave të lokaliteteve. Shpresoj që ky buxhet të votohet në mënyrë unanime nga gjithë anëtarët e kuvendit për realizimin e 242 projekteve investive, që janë paraparë në bashkëpunim me të gjitha subjektet politike dhe me qytetarët.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**u përgjigj në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit, duke sqaruar se pajtohet që analitika e rrugëve të mos ndryshohet të mbetet e njëjta. Lidhur me kërkesat për projekte kapitale të parashtruara nga anëtarët e kuvendit, kërkoj mirëkuptim nga ta sepse do të jetë e vështirë realizimi i tyre pasi që në buxhet janë planifikuar shumë projekte më shumë se gjysma e projekteve nga viti i kaluar por përvareshit kësaj do të jetë e vështir përmbushja e të gjitha kërkesave dhe nevojave për qytetaret. Lidhur me bursat premtoj se do të rritet numri i tyre dhe do të ri-hartohet rregullorja për bursat pasi që ka mjaft shumë defekte dhe po ashtu do të shtohen fondet për menaxhimin me qenët endacak. Lidhur me kërkesën për asfaltimin e rrugës në Lagjen-Dautaj-Pasomë, shtjelloj se ekziston një kontratë që obligon operatorin ekonomik-që shfrytëzon gurin-gurëthyesi që të bëj asfaltimin e asaj rruge. Për kërkesat e fshatit Stanoc, ceku se kishte shumë projekte por duhet të përzgjidhen vetëm dy apo tri projektet sepse nuk ka fonde dhe duhet të hapen kode të reja për secilin projekt. Lidhur me projektin ndërtimi i tribunave në stadiumin "Ferki Aliu" njoftoj se është në negociata me Ministrin e Kulturës për bashkëfinancim të këtij projekti. Për renovimin e çerdhes të qytetit janë planifikuar 170,000.00 €. Tek rrejti i ujësjellësit në fshatin Stanofc të shtohet dhe inkorporohet edhe shtrim i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Gracë, por edhe dy apo tri rrugë me prioritet të futen në buxhet në fshatin Stanoc nga pozicioni të <hyrat e bartur>.  Në fund pasi i falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë, kërkoj që buxheti i Komunës së Vushtrrisë të votohet me vota unanime.
**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me projekt-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-** propozoi që të gjitha kërkesat e anëtarëve të kuvendit të inkorporohen si projekte për vitin 2024, ashtu që të hapet kodi ekonomik për këto projekte dhe që të mundësohet që këto projekte të realizohen nga të hyrat e bartura.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë  të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2023-2025, konform Qarkoreve Buxhetore 2022/01 dhe 2022/02 për komuna të lëshuara nga MFPT-ja, për vitin 2023 dhe projeksionet për vitin 2023 dhe 2025.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023 është **23,373,910 €,** prej të cilave për:

| | **Kategoritë buxhetore** | **2023** | **2024** | **2025** |
|---|---|---|---|---|
| **1.** | Paga dhe mëditje | 10,796,373 € | 10,850,355 € | 10,904,607 € |
| **2.** | Mallra dhe shërbime | 3,904,187 € | 3,999,000 € | 4,047,393 € |
| **3.** | Shpenzime komunale | 472,500 € | 498,200 € | 518,128 € |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **4.** | Subvencione | 942,000 € | 990,000 € | 1,059,070 € |
| **5.** | Shpenzime kapitale | 7,258,850 € | 8,590,845 € | 9,393,711 € |
| | **Totali:** | **23,373,910** | **24,928,400 €** | **25,922,909 €** |

3.Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023..................................................2,900,559.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 2022/01 dhe 2022/02 të MFPT-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitet 2023-2025, (kopja e shtypur prej SZHMB, vulosur, nënshkruar nga Kryetari i komunës dhe ZKF). Tabela 4.2 – financimi i projekteve kapitale për vitin 2023 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2023-2025 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur, si dhe nënshkruar nga Kryetari i komunës dhe ZKF-ja). Tabelat 4.3 plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur, nënshkruar nga Kryetari i komunës dhe ZKF-ja), si dhe tabelat e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi/ja i/e kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

**4.** Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2022;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit**-tha se ashtu siç ishim konstruktivë kur erdhi një plan i mirëfilltë buxhetor për vitin 2023, ashtu do te ju mbajmë përgjegjës kur gjerat nuk janë duke shkuar mirë. Ka pasur ngecje ne realizimin e të gjitha kategorive buxhetore. Vonesa në inicim te procedurave mos inicim te procedurave, vonesa ne realizimin e projekteve të gjitha kane një emërues të përbashkët ngecjen e zhvillimit të projekteve dhe zhvillimit ekonomik të gjithmbarshëm te komunës. Të dhënat e institute GAP 19% është mesatarja e realizimit buxhetor për investime kapitale në nivel te gjitha komunave te Kosovës e ne jemi shume poshtë të renditur. Në këtë nivel i kemi mallrat dhe shërbimet vetëm 28% të realizuara, shpenzimet komunale janë më të mëdha janë 50% dhe ka një mori të projekteve të cilat janë shume të rëndësishme që nuk janë iniciuar furnizimi me gjenerator, procedura, furnizimi me montim te kamerave ne shkollat fillore dhe ne QMF ,furnizimi me kabllot optike nuk është iniciuar, furnizimi me flamuj për nevoja të AK Vushtrri ,furnizimi me lodrat e fëmijëve, furnizimi me teknologji informative ,furnizimi me aparate fotokopjuese, furnizimi me libra për bibliotekën e qytetit dhe shkolla, furnizimi me xhama te administratës ,furnizimi me kupa dhe medalje aktivitete kulturore, shërbimet e arsimit dhe trajnimit, servisimi dhe mirëmbajtja e ngrohjeve, mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal e horizontal ,mbarëvajtja dhe servisimi i serverit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave, servisimi dhe nevojat e automjeteve ,servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, pastrimi ,fshirja dhe larja e rrugëve ,pastrimi dhe larja e automjeteve, shërbime me tenda dhe zërmi ne aktivitetet kulturore, ndërtimi me kubëza betoni rrugëve “Skënderbeu”, “Bekim Zenuni”, “Mursel Hyseni”, sinjalizimi horizontal-vertikal rrugëve “Deshmoret e Kombit”, “Ismail Qemajli”, “Bekim Berisha”, ndërtimi

i shesheve dhe parqeve në qytet ,ne Strofc ,Smerkonicë ,zgjerimi i rrjetit publik te ndriçimit ne Vushtrri ,Doberllukë, Maxhunaj ,ndërtimi i rrugëve lokale ne fshatra, ndërtimi i parqeve, rregullimi i argjinaturave lumi Sinica, renovimi i palestrës "Jeton Tërstena", ndërtimi i objektit ndihmës te stadiumit, renovimi i ngrohjes qendrore i shkollës profesionale, ndërtimi i shkollës ne fshatin Gllovotinë të gjitha këto projektet të numëruara nuk janë iniciuar apo ndodhen në procedurë dhe kjo me të vërtet është tepër e dëmshme dhe do të ketë pasoja për komunën. Në faqen 23 tek shërbimet shëndetësorë rëntgeni i dhëmbit thotë qe ka 0% shërbime janar-qershor 2022 kjo është shqetësuese kur janë dy aparate të rëntgenit në QKMF dhe krijon dyshim se mos dikush nga organet është duke i shërbyer ndonjë ordinance stomatologjike private. Në fund tha se është shumë skeptik që këtë vit do të realizohen këto projekte dhe shto se përpos që mjetet do të shkojnë në suficit cili do të jetë fati këtyre projekteve që janë votuar a do të pushojnë si obligime ndaj komunës.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-** duke ju referuar diskutimit të parafolësit tha se, tek kontratat për furnizim ku nga 70 kontrata të planifikuara janë realizuar vetëm 22 apo 31.42%,ne procedurë te prokurimit janë 28 kontrata apo 40%, 20 kontrata nuk janë iniciuar fare apo 28.6 %. Përqindja e realizmit të investimeve kapitale është tepër shqetësuese në vetëm 2.43 %. Tek furnizimi me lëndë djegëse dru për ngrohje thuhet se është në procedurë të prokurimit. Pyetje për drejtoreshën e arsimit se deri ku ka shkuar procedura? A janë të gjitha shkollat të furnizuara me gjenerator? Testi i arritëshmerisë në përqindje në nivel komunal është 44.74%. A keni planifikuar të merrni masa që kjo përqindje e testit te arritshmerise për vitin e ardhshëm shkollor të jetë me e madhe?
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-** duke ju referuar diskutimeve të parafolësve tha, tek Drejtoria e Kulturës kanë qenë 14 projekte për kontrata për furnizim 1 është iniciuar, 6 janë proceduar dhe 7 nuk janë iniciuar. Tek raporti i drejtorisë dua ta cek se çdo kund në dokumente zyrtare na vjen "Teatri i Qytetit" ndërsa teatri e ka emrin zyrtar "Adem Mikullovci" për ketë emër është votuar në këtë kuvend. Tek raporti i Drejtorisë për Shërbime Publike thuhet se ka pasur furnizim me ujë kënaqshëm, një pjese e madhe e qytetit ka pasur probleme me furnizimin me ujë të pijshëm, kjo nuk mund të thuhet se është reale.

**5.** Shqyrtimi i propozim –vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave;

**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit:** pyetje për Drejtorin e Financave. A është koeficienti me i vogël apo me i madh ne krahasim me vitin e kaluar?
**Isuf Jashari, drejtor i buxhetit dhe financave:** tha se për shkak të gjendjes ekonomike kemi paraparë këto norma të cilat është norma me e ulët për vitin 2023. Mundemi t'ua rrisim mirëpo për shkak te gjendjes ekonomike në të cilën jemi, kemi menduar që paraprakisht të shkojmë për vitin 2023 me këtë normë tatimore, ndërsa sa ju përket normave të tjera ato janë të rregulluara me ligj.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit:** tha, se duhet të sqarohet në dy pozicionet, pozicioni i parë me problem është të bëhet vlerësimi i pronave konform ligjit sesa norma tatimore, ka pasur pengesa dhe mosrealizim të rivlerësimit të pronave në vazhdimësi. Ndarja në zona gjithashtu është problem që prek shumë qytetar, bizneset dhe pronar të pronave të ndryshme. Këto dy probleme inkorporohen me këta koeficient qe janë paraparë dhe efekti i ngarkesës në vlerë për qytetaret nuk ndikon shume përqindja sa ndikon vlerësimi real i pronave. Shembulli është se nga hyrja e qytetit e deri tek ura e hekurti duke vazhduar deri tek në dale nga Mitrovica, është përkufizuar si zona e parë dhe vlerësimi i pronës sipas tregut është i njëjtë dhe po ashtu edhe normat tatimore, gjë për të cilën po ka ankesa nga qytetarët për vlerësim jo real. Është e rëndësishme që konform ligjit të bëhet rivlerësimi i pronave sipas vlerës së tregut, në këtë kontekst është tepët e nevojshme që të formohet një grup punues që do të merret me këtë çështje ashtu që të veprohet shpejt dhe drejt

sepse shumë qytetar-pronar paguajnë tatim për vlerën e pronës që në realitet nuk e ka.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota "unanime" vendoi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim bëhet caktimi i normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave me përjashtim të kategorisë pronë publike, dhe atë si në vijim:

| Lloji i pronës | Norma e tatimit në % |
|---|---|
| Pronë rezidenciale (banesë-apartmant) | 0,15 |
| Njësi rezidenciale-parcelë | 0,15 |
| Pronë rezidenciale - shtëpi | 0.15 |
| Pronë komerciale | 0.21 |
| Njësi komerciale-parcelë | 0,18 |
| Pronë industriale | 0.18 |
| Njësi industriale-parcelë | 0,18 |
| Pronë bujqësore | 0.15 |
| Njësi bujqësore-parcelë | 0,15 |
| Njësi pyjore parcelë | 0,15 |
| Pronat e pameremetuara dhe jo të gatshme për banim | 0.15 |
| Garazhet | 0.15 |
| Objektet e braktisura | 0.15 |
| Pronat komerciale (pishinat, fushat sportive etj). | 0.21 |
| Pronat e pameremetuara dhe jo të gatshme komerciale | 0.20 |

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**6.** Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore;

**7.** Rishikimi i planit te veprimit për të gjeturat e auditorit;

**Isuf Jashari drejtor i DBF-së-** tha, se të gjitha rekomandimet e auditorit gjeneral ne jemi të obliguar që ti zbatojmë , është e detyrueshme që kuvendin ta informojmë se deri ku ka mbërri procedura e vlerësimit të rekomandimeve të dhëna nga auditori gjeneral. Jemi duke bashkëpunuar me secilën drejtori ku janë dhënë rekomandimet dhe të bëjmë implementimin e tij, në mënyrë që këtë vit kur të bëhet auditimi, të kemi më të lehtë dhe të kemi sa më pak rekomandime.

**8**.Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënien ne shfrytëzim te pronës komunale

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit** :tha, këtë informate dhënien ne shfrytëzim kam kërkuar të plotësohet, ka pasur ndërrime të drejtorëve ,nuk e di faqja e pare ndoshta është bere nga dikush tjetër, faqet pasuese nga dikush tjetër ,vetëm shiko nivelin e kualitetit te tabelave , te prera stema e komunës ,nuk shkruan as drejtoria si duhet është ofendim me na e sjell kështu, nuk është ne nivel akademik, gjysma e tabelave dalin ne faqe te tjera nuk dihet kujt i referohet ,nëse ka probleme ne exelin dikush nga stafi është mire të iniciohet procedura qe është për trajnime profesionale ne arsim. Kështu tabela te sjellën shikoni çfarë na ka ardhur ,duhet te trajtohemi pak me serioz.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit :** tha , ne fillim të seancës para rendit te ditës dhashë një propozim, por me pati vullnet ose është kaluar pa u diskutuar ,duke pasur parasysh këtë informatë qe e kemi para vetes , e shohim indeksimin me te vërtet shume te ulet ,si komunë duhet te marrim masa qe te jete inkesnmin konform qirave qe e kane bizneset ose te sillet ne kuvend një propozim vendim për lirim edhe për këtë vit.
**Melihate Basholli-Latifi , kryesuese e kuvendit** : tha ,jo qe nuk ka interesim por kjo çështje duhet të kaloj përmes KPF-se.
**Remzi Ahmeti, drejtor për gjeodezi dhe kadastër**: tha, kemi dërguar te gjitha vërejtjet tek qiramarrësit . Tek lista besoj qe nuk janë shtypur exeli nuk ka qen i njëjtë prej aty ku është dërguar ne email, por këtë është çështje teknike e përmirësoj edhe do t'ua sjell.

**Pas debati kuvendi kaloj ne piken e radhës te rendit te ditës.**

**9**. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit

**Ne këtë pike te rendit te ditës nuk pasi diskutime nga anëtaret e kuvendit**

**10**. Shqyrtimi i njoftimit (agjendës) te komisionit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale të Komunës se Vushtrrisë

**11.** Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh;

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-** në cilësinë e kryesuesit të komisionit për verifikimin e procesit të dhënien së pronës në shfrytëzim në mënyrë të detajuar paraqiti para kuvendit raportin për të gjeturat në Parkun Industrial në Lumadh në vijim gjeni pjesë nga raporti i këtij komisioni që konsiderohen si substanca e çështjes që referuesi i parashtron para kuvendit dhe atë si në vijim: Komisioni kuvendar për verifikimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, identifikimin e pronave që janë të uzurpuara, si dhe verifikimi i shfrytëzimit të parcelave private ku janë ndërtuar objektet ndërtimore- banesore -kolektive dhe objektet tjera në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën kohore 1999-2022, në lidhje me verifikimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, me numër të protokollit nr.81/21 të datës 16.04.2021, ka hartuar dhe sjellë para jush raportin përfundimtar: Duke u bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës nr. 101/22, të datës 28.04.2022, për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, ka mbajtur takimin e parë në datën 02.06.2022. Në takimin e parë, kryesuesi i komisionit është zgjedhur Bekim Zabërgja, ndërsa procesmbajtëse është zgjedhur Zoja Hajrizi. Komisioni, për shkak të rëndësisë së procesit, me prioritet ka shqyrtuar dhe verifikuar procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në Zonën Ekonomike, përkatësisht - Parkun Industrial në Lumadh, bizneseve private nga parcela të evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe

P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 Ha, në Zonën Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Komisioni ka mbajtur disa takime duke kërkuar dokumentacionin e nevojshëm nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyra Ligjore, Sekretaria e Kuvendit dhe Zyra e Kryetarit të Komunës dhe pas kompletimit të dokumentacionit përkatës, në vijim:

1. Vendimi i Kuvendit Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale me nr.239/2020, të datës 26.11.2020.

2. Vendimi i Kuvendit të Komunës për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial Lumadh nr. 241/20, të datës 26.11.2020.

3.Vendimi i Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale me nr. 240/20, te datës 26/11.2020

4. Vendimi i Kuvendit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e komisionit vlerësues nr. 270/20, të datës 30.12.2020.

5.Vendimi nr. 269/20, i datës 30.12.2020 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës për shpalljen e Konkursit Publik, me nr të protokollit 01.Nr. 241/20, i datës 26.11.2020

6. Procesverbalet e dy mbledhjeve të komisionit për vlerësim të ofertave për Parkun Industrial Lumadh, të datës 05.03.2021 dhe datës: 12.03.2021

7. Formulari për aplikim

8.Rekomandimi i Komisionit vlerësues, të datës 31.03.2021

9. Vendimi i Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, nr.81/21 të datës 16.04.2021

10. Lista e 43 bizneseve private të cilat kanë aplikuar në konkurs

11. Dokumentacionin e 22 bizneseve private përfituese të pronë së paluajtshme në Parkun Industrial Lumadh,

12. Dokumentacionin e 21 bizneseve private jopërfituese

13. Opinioni i Zyrës Ligjore të Komunës së Vushtrrisë nr.71340/21, të datës 23.12.2021

14.Opinioni i Agjencisë kundër Korrupsionit me nr. 06-02/1326/22, të datës 25.03.2022

15.Opinioni i Zyrës Ligjore të Komunës së Vushtrrisë, nr. 21013/22, të datës 26.04.2022

16. Procesverbalin e komisionit për pranim teknik të punëve për projektin **“Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial Lumadh”** nga MTI, me nr. 076-12, të datës19.05.2022

Bazuar në nenin **11**, paragrafi **2**, të **Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike**, nenin **17**, të **Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës**, nenin **14** të **Rregullores (QRK) Nr. 09/20**, nenin **3**, paragrafi **2** të **Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 03/2014**, për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për

vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, vlerësohen duke marrë për bazë këto kritere:

1. Veprimtaritë e lejuara në Parkun Industrial,

2. Përparësitë për vendosje në Parkun Industrial,

3. E drejta e aplikimit,

4. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim,

5. Kriteret për vlerësim.

Në ***dokumentacionin e nevojshëm për aplikim***, bizneset private për t'u vendosur në Parkun Industrial, duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

1. Formularin e plotësuar me të dhëna të kërkuara,

2. Certifikatën e regjistrimit të biznesit,

3. Historiati i kompanisë (biznesit),

4. Veprimtarinë që do ta zhvillojë,

5. Projektin ideor.

**Gjatë shqyrtimit** nga ana e komisionit kuvendar, prej 22 (njëzet e dy) bizneseve private përfituese për t'u vendosur në Parkun Industrial, komisioni ka konstatuar se 5 (pesë) prej bizneseve nuk e kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për aplikim. Këto biznese janë:

1. **Emona Center sh.p.k**. – përfituese e pronës së paluajtshme në madhësi prej **60 ari**, i ka munguar: **Historiati i Biznesit.**

2. **AJNE CAKE** – përfituese e pronës së paluajtshme në madhësi prej **65 ari**, i ka munguar: **Projekti Ideor**

3. **Euro Driloni -** përfituese e pronës së paluajtshme në madhësi prej **40 ari,** i ka munguar:

**Projekti Ideor.**

4. **Ra EXIMP – sh.p.k**. - përfituese e pronës së paluajtshme në madhësi prej **30 ari,** i ka munguar: **Historiati i Biznesit.**

5. MATEO COMPANY – sh.p.k. - përfituese e pronës së paluajtshme në madhësi prej **35 ari,** i ka munguar: **Historiati i Biznesit.**

Te 21 (njëzet e një) bizneset private të cilat kanë aplikuar dhe nga Komisioni Vlerësues janë refuzuar, komisioni kuvendar gjatë verifikimit të dokumentacionit përkatës ka konstatuar se prej tyre 5 (pesë) biznese private e kanë pasur të plotësuar ***dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.*** Këto biznese janë:

1. SMC GROUP,

2. Fatlumi Metal,

3. Valmir Halili B.I.

4. Behari sh.p.k.,

5. Burimi Dekor NTP.

Në bazë të pikës 8 të konkursit, kriteret për vlerësim janë:

| | |
|---|---|
| Punësimi | 40 pikë, |
| Vlera investive | 30 pikë, |
| Lloji i veprimtarisë | 30 pikë, |
| Prodhuese | 30 pikë, |
| Përpunuese | 30 pikë, |
| Shërbyese | 10 pikë. |

**Gjatë shqyrtimit** nga ana e komisionit kuvendar, komisioni konstaton se në dy procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të mbajtura në datat 05.03.2021 dhe 12.03.2021, ekzistojnë fakte se Komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me kriteret për vlerësim bazuar në pikën 8 të konkursit, **duke mos i kuotizuar me pikë asnjërin prej bizneseve përfituese të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial – Lumadh.**

**Provë: 1.** Procesverbali i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, i datës 05.03.2021 dhe

**2.** Procesverbali i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, i datës 12.03.2021.

- Bizneset private të cilat janë shpallur fituese dhe të cilave u është njohur e drejta për t'u vendosur në zonën ekonomike, me rastin e nënshkrimit të kontratës, kanë qenë të obliguara të sjellin dokumentacionin si në vijim:

**1. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për përmbushjen e obligimeve tatimore,**

**2. Dëshmi nga ATK për numrin aktual të punësuarve,**

**3. Planin e Biznesit,**

**4. Garancionin Bankar prej 5% të vlerës së investimit.**

**Gjatë shqyrtimit** të dokumentacionit nga ana e komisionit kuvendar për shqyrtim, komisioni ka konstatuar se nga 22 bizneset private përfituese të pronës, vetëm 2 biznese private (1. BTP HOLDING dhe 2. RA EXIM sh.p.k.) posedojnë garancionin bankar, ashtu si është paraparë sipas Planit Ideor dhe Planit të Biznesit. Ndërsa 20 bizneset tjera përfituese, komisioni ka konstatuar se posedojnë garancionin bankarë në afat kohor prej 30 ditësh, gjë që është në kundërshtim me Planin Ideor dhe Planin e Biznesit, në kundërshtim me kriteret e konkursit.

Biznesi privat **BERTO sh.p.k**., përfitues i madhësisë së tokës prej **1 ha,** përpos garancionit bankarë, komisioni konstaton se biznesi në fjalë nuk e ka sjellë dokumentin e nevojshëm- Vërtetimin nga ATK-ja, për përmbushjen e obligimeve tatimore, por ka sjellë një marrëveshje për

pagesë të borxheve tatimore me këste të datës 13.01.2021, me nr. të protokollit **ATK-OMB-4973,** e cila marrëveshje nuk është kritere sipas dokumentacionit të paraparë me konkurs.

Te kompania **MATEO Company sh.p.k**. me certifikatë të regjistrimit nr. **811488792**, e cila ka përfituar 35 ari pronë të paluajtshme, komisioni kuvendar gjatë verifikimit të dokumentacionit të kompanisë, ka konstatuar se kompania në fjalë përpos që i mungon Historiati i Biznesit, e njëjta është themeluar me 15.12.2020, që i bie 19 ditë pas shpalljes së konkursit të datës 26.11.2020 nr. 241/20 për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial. Dhe nga ATK-ja posedon vetëm një punëtor.

**Provë: 1**. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit nr. **811488792**, e datës 15.12.2020

**2.** Lista e punëtoreve nga ATK-ja, e datës 15.06.2021

Komisioni për Vlerësim të Ofertave për Park të Biznesit në Fshatin Lumadh-Vushtrri i cili gjatë vlerësimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim me Nenin 11, pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, në kundërshtim me Nenin 21 të Rregullores së QRK-së Nr.09/2020, në kundërshtim me Nenin 19, paragrafi 3, të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, me Nenin 7, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 03/2014, me datën 31.03.2021 sjellë në Kuvendin e Komunës dhe i propozon Asamblesë Komunale në Vushtrri, ashtu siç është vendosur nga Komisioni për vlerësim të ofertave ta përkrahin dhe t'i japin mbështetje.

**Provë:** Rekomandimi i Komisionit për Vlerësim të Ofertave për Park të Biznesit në Fshatin Lumadh-Vushtrri, i datës 31.03.2021

Komisioni kuvendar për shqyrtimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim gjatë verifikimit të Procesverbalit nga Mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 16 prill 2021, ka gjetur se në procesverbal është konstatuar se njeri nga anëtarët e Komisionit për Vlerësim të Ofertave dhe njëherazi anëtarë i Kuvendit të Komunës Ilmi Azemi dhe anëtari tjetër Kuvendit Komunal ne Vushtrri z.Fitim Halili, e kanë njoftuar Kuvendin se prezenca e tyre në sallën e Kuvendit shfaq konflikt interesi lidhur me vendimmarrje, mirëpo edhe pse e kanë bërë një gjë të tillë, ata kanë qëndruar në sallë me arsyetim se vota e tyre me abstenim nuk do të ketë ndikim në vendimmarrje. Komisioni kuvendar ka konstatuar në bazë të procesverbalit se në sallë nga 35 anëtarë sa i ka Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, prezent kanë qenë 19 anëtarë të Kuvendit, 13 prej tyre kanë votuar për, dy vota kundër dhe 3 vota abstenim. Ndërsa votat e tyre abstenim kanë qenë thelbësore dhe përcaktuese për formimin kuorumit. Në këtë rast zyrtarët kanë vepruar në kundërshtim me Nenin 17 (pika 1) të Ligjit Nr. 06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

**Provë:** Procesverbali nga Mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 16 prill 2021.

Gjatë shqyrtimit komisioni kuvendar ka konstatuar se Kryesuesja e Kuvendit Komunal në Vushtrri, znj. Melihate Basholli – Latifi, i është drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit ku ka kërkuar shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit, lidhur me pretendimet se **z. Ilmi Azemi**, duke qenë anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, i cili ka deklaruar konflikt interesi në raport me biznesin **Sh.p.k. "Mateo Company"** dhe **z. Fitim Halili**, gjithashtu anëtar i Kuvendit Komunal, ka deklaruar po ashtu konflikt interesi në lidhje me biznesin **Sh.p.k. "BINA"** dhe që duke abstenuar në votim, nëse i kanë mundësuar ta bëjnë kuorumin në lidhje me vendimmarrjen nr.

81/21, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial “Lumadh”. Ndërsa më 24.03.2022 **Agjencia kundër Korrupsionit** me nr. të referencës **06-02/1326/22**, sjellë **OPINION** në lidhje me trajtimin e rastit të konfliktit të interesit. Opinion me të cilin AKK konstaton se, ekziston konflikti i interesit për zyrtarët e lartë **z. Ilmi Azemi** dhe **z.Fitim Halili**, anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri dhe Agjencia i kërkon shqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit.

**Provë: OPINIONI** i Agjencisë kundër Korrupsionit në lidhje me trajtimin e konfliktit të interesit, i datës 25.03.2022, me nr. të referencës **06-02/1326/22.**

Komisioni kuvendar për verifikimin gjatë shqyrtimit të 22 kontratave përfituese të pronës së pa luajtshme në parkun industrial në Lumadh me autoritetin kontraktues përkatësisht komunën e Vushtrrisë, komisioni ka konstatuar se ish-kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri ka keqpërdor funksionin e tij dhe ka abuzuar duke nënshkruar kontrata në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës NR.06/L-092 neni 9 paragrafi 5, e drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë.

Si rrjedhojë e veprimeve të tija të kundërligjshme, komisioni gjatë shqyrtimit të kontratave në fjalë konstaton se ka hasur se dy biznese private përfituese të pronës në parkun industrial në Lumadh e kanë arritur marrëveshje duke lidhur “**Kontratë për Marrëdhënien e Nënqirasë”**. Bizneset private të cilat e kanë bartur pronën tek personat e tretë janë :

1. **7 VËLLEZËRIT SH.P.K – Vushtrri** parcela me sipërfaqe prej 65 ari me nr të njësisë kadastrale **P-70202011-00435-4** me datën **24.08.2021** e bartë pronën te biznesi **privat Blerim Merovci B.I, D.P.T “ARIANI-1”** e noteruar me **nr.rend. 9711/2021** te noteri Bardhyl A. Dinaj e cila marrëveshje është e evidentuar në agjencinë kadastrale në cilësinë e nënqiramarrësve **nr.18/1850/22 të datës 13.06.2022.**

**Provë : 1. Kontrata në mes të palëve kontraktuese 7 VELLEZERIT SH.P.K dhe Blerim Merovci B.I, D.P.T “ARIANI-1” e datës 24.08.2021.**

**2. Certifikata e njësisë kadastrale me nr të lëndës nr.18-1850/22 data 20.09.2021**

2. Biznesi privat **AJNA CAKE SH.P.K- Vushtrri** përfituese e pronës me sipërfaqe 65ari me nr të njësisë kadastrale **P-70202011-00435-5** përmes **“KONTRATËS PËR MARRËDHËNIEN E NËNQIRASË”** më datën **23.08.2021** përmes noterit Bardhyl A. Dinaj e bartë pronën tek biznesi privat **DEKRA MOBILERI SH.P.K** e cila marrëveshje është e evidentuar në agjencinë kadastrale në cilësinë e nënqiramarrësve **nr.18/1850/22 data 20.09.2021.**

**Provë : 1. Kontrata në mes të palëve kontraktuese AJNA CAKE SH.P.K dhe DEKRA MOBILERI SH.P.K e datës 23.08.2021**

**2. Certifikata e njësisë kadastrale me Nr të lëndës nr.18-1850/22 data 20.09.2021**

Komisioni verifikues gjatë shqyrtimit të kontratave në fjalë ka hasur në një kontratë për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës të lidhur më datën **14.06.2021** në mes **të komunës së Vushtrrisë e përfaqësuar nga kryetari Xhafer Tahiri dhe Kryesuesi i**

**komisionit Adnan Lahu dhe operatori ekonomik IFA-INDUSTRY SH.P.K** me ç' rast komisioni ka konstatuar se biznesi në fjalë IFA-INDUSTRY SH.P.K nuk ka qenë përfituese sipas komisionit vlerësues për vendosjen e bizneseve në parkun industrial si dhe nuk është përzgjedhur në bazë të vendimit të kuvendit komunal me **nr.81/21 të datës 16.04.2021** dhe po ashtu komisioni ka hasur edhe në një dokument siç quhet **"LETER KONZORCIUMI"** të lidhur në mes të "CIAO BERTO" dhe "IFA INDUSTRY" në të cilën thuhet se këto dy kompani aplikojnë në zonën industriale në Lumadh si dy kompani të ndryshme por komisioni konstaton se kompania "CIAO BERTO" nuk ekziston si e tillë, nuk posedon certifikatë të biznesit dhe llojin e veprimtarisë dhe asnjë dokument tjetër nga ARBK-ja si biznes aktiv , andaj komisioni konstaton se përpos kësaj **ish-kryetari I Komunës Xhafer Tahiri dhe Kryesuesi i komisionit Adnan Lahu**, operatorit ekonomik "IFA INDUSTRY" i ka ndarë prone me sipërfaqe prej 50ari pas përfundimit të procedurave dhe kritereve të konkursit, e cila prone është e evidentuar në agjencinë kadastrale me nr **P-70202011-00435-6 me nr të lëndës 18-1850/22 të datës 13.06.2022.**

**Provë : 1.“KONTRATA PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS"** përfaqësuar nga **kryetari Xhafer Tahiri** dhe Kryesuesi i komisionit **Adnan Lahu dhe "IFA INDUSTRY" SH.P.K** me seli në Vushtrri.

**2."LETËR KONZORCIUMI" e nënshkruar në mes të "CIAO BERTO" dhe "IFA INDUSTRY" me datën 20.01.2021.**

**3. Certifikata e njësisë kadastrale me nr të lëndës nr.18-1850/22 data 13.06.2022**

Komisioni verifikues gjatë shqyrtimit te dokumentacionit ka konstatuar se biznesi privat **Fatime Hasani Shabani BI „TIME. N.T.P** me numër unik identifikues **810893158** me nr. të mëparshme të biznesit: **70622823** me seli në Prishtinë e cila ka përfituar pronë me sipërfaqe 60 ari, me datën 15.12.2021 i drejtohet Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë gjegjësisht zyrës Kadastrale Komunale me kërkesë për ndarjen e sipërfaqes së përfituar në dy njësi Kadastrale nga 30ari.

Zyra Kadastrale komunale në Vushtrri me datën 26.01.2022 nxjerr **AKTEVENDIM** nr. **18-69950/22** në të cilën refuzon kërkesën për ndarjen të njësisë kadastrale, me arsyetim se është në kundërshtim me nenin 19 paragrafi 5 i ligjit nr. 06/L/92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale.

**Provë: AKTEVENDIMI i zyrës Kadastrale nr.18-69950/22 i datës 26.01.2022**

Komisioni gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga zyra e kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi ka hasë një kërkesë për opinion ligjor lidhur me kontratat e parkut të biznesit në fshatin Lumadh drejtuar zyrës ligjore përmes drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronë të datës **22.12.2021** me **nr.71103/21** ku ka kërkuar opinion ligjorë lidhur me faktin se a janë në kundërshtim paragrafi 3 i nenit 3 dhe paragrafi 6 i nenit 8 lidhur me paragrafin 8 të nenit 9 të kontratave në fjalë.

Zyra ligjore me datën **23.12.2021** pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë dhe konsultimit të legjislacionit në fuqi sipas të cilit rregullohet kjo fushë ka dhënë opinion ligjorë :

**1. Neni 9 i paragrafit 8 i kontratave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës ( në parkun industrial në fshatin Lumadh) është në kundërshtim të plotë me paragrafin 5 të nenit 19 t ë Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.**

**2. Zyra Ligjore rekomandon që të gjithë operatorët ekonomik (përfituesit e pronave në parkun industrial) të informohen me shkrim nga autoriteti kontraktues – kryetari i Komunës, që dispozita e kundërligjshme e kontratës duhet të anulohet përmes aneks-kontratës.**

**3. Gjithashtu të gjithë operatorëve ekonomik (përfituesit e pronave në parkun industrial) t'iu tërhiqet vërejtja, se çdo veprim për bartje të pronës në personat e tretë është e kundërligjshme dhe tërësisht e pavlefshme.**

**Provë : 1. Kërkesa për opinion ligjor lidhur me kontratat e parkut të biznesit në fshatin Lumadh**

**2. Opinioni ligjor i zyrës ligjore të komunës së Vushtrrisë me nr.71340/21 i datës 23.12.2021**

Po ashtu komisioni kuvendar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit konstaton se zyra ligjore me kërkesë të kryetarit të komunës z.Ferit idrizit me datën 26.04.2022 me nr. 21013/22 i është drejtuar udhëheqësit të zyrës Ligjore në Vushtrri z.Ismet Gashit me kërkesën për interpretimin e opinionit Ligjor të Agjencisë Anti Korrupsion AKK se a ka pas konflikt interesi me rastin e marrjes së vendimit 81/21 në seancën e jashtëzakonshme të KK Vushtrri të datës 16.04.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parkun e biznesit Lumadh. Autoritetet Komunale përkatësisht Kuvendi i komunës së Vushtrrisë brenda afateve të rekomanduara duhet të rishqyrtoj, revokoj apo shfuqizoj vendimin nr.81/21 të datës 16.04.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në Parkun Industrial në Lumadh, sepse procesi i votimit është përfshirë me shkelje të dispozitave të cilat e përcaktojnë konfliktin e interesit.

**Provë:** Opinioni Ligjorë i udhëheqësit të zyrës ligjore z.Ismet Gashi nr.21013/22 i datës 26.04.2022.

Komisioni gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se komisioni për pranim teknik i MTI përkatësisht agresioni për investime dhe përkrahje të ndërmarrjeve në Kosovë "KIESA" me datën 19.05.2022, me nr.3076-12 ka bërë pranimin teknik të projektit kapital "Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh", sipas kontratës 2608 të datës 21.03.2019, me nr. të prokurimit MTI204-18-8650 fraksion/042-5-1-1 dhe aneks-kontratës me nr.2374 me nr. të prokurimit MTI204-18-8650fraksion 042-5-1-1/204-19-7738-5-2-5 me datën 12.11.2019.

**Provë: Procesverbali i komisionit për pranim teknik i MTI nr.3076-12 i datës 19.05.2022**

Komisioni kuvendar për verifikimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim pas administrimit të provave të nevojshme të cekura më lartë i paraqet këtë:

## R E K O M A N D I M

**1. Shfuqizimin e vendimit të kuvendit komunal me numër 81/21 të datës 16.04.2021 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në Parkun e Biznesit në Lumadh,**

**2. Anulimin dhe shfuqizimin e të gjitha kontratave të lidhura ne mes komunës së Vushtrrisë dhe operatorëve ekonomik në Parkun Industrial në Lumadh,**

**3.Shpalljen e konkursit publik për vendosjen të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh, sipas afateve të parapara me ligj.**

## A R S Y E T I M

Komisioni kuvendar për verifikimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim:

Me qëllim të shqyrtimit të këtij rasti komisioni ka kërkuar dhe pranuar dokumentacionin e nevojshëm dhe informatat shtesë nga drejtoria për Kadastër dhe Pronë, drejtoria e Urbanizmit, zyra e kryetarit, zyra ligjore, zyra e sekretarisë së kuvendit, dhe më pas komisioni ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

1.Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim ka vepruar në kundërshtim me nenin 19 të rregullores së (QRK )me nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës,

2. Komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 të udhëzimit administrativë MTI nr.03/2014,

3. Vendimi i kuvendit komunal në Vushtrri nr.81/21 i datës 16.04.2021 është bërë në kundërshtim me:

- ligjin 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit,

-ligjin 03/L-040 për vetëqeverisje lokale konkretisht neni 38 i këtij ligji, për shkak se ekziston konflikt interesi për dy anëtarët e kuvendit:

Ilmi Azemi, Fitim Halili

4. Kryetari i komunës Xhafer Tahiri dhe kryesuesi i komisionit Adnan Lahu ish drejtor për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, me rastin e nënshkrimit të kontratave me bizneset përfituese kan vepruar në kundërshtim me ligjin nr.06/L-092, neni 19 paragrafi 5 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, ku thuhet citojmë: “ E drejta e shfrytëzimit të pronës të paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë”.

5. Ish drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë z.Adnan Lahu njëherazi kryesues i komisionit vlersues, operatorëve ekonomik 7 vëllezërit SH.P.K cili e ka bartë pronën tek DPT Ariani me nr. 18-1850/22 të datës 20.09.2021, me nr. të parcelës P-79202011-00435-4, dhe kompanisë Ajna Cake SH.P.K i cili e ka bartë pronën tek biznesi privat Dekra mobilieri SH.P.K, me nr. 18-1850/22 të datës 20.09.2021, me nr. të parcelës P-70202011-00435-5 dhe ju ka mundësua evidentimi në agjencinë Kadastrale në cilësinë e nën qiramarrësve.

6. Pranimi teknik nga MTI i projektit kapital “Ndërtimin i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh” është bërë me datën 19.05.2022 pra të gjitha procedurat për shpalljen e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme nga ana e komisionit dhe qeverisë komunale janë kryer në kundërshtim me ligjin.

Në fund kërkoj nga ana e kuvendit që ta mbështet raportin e komisionit duke e aprovuar me të gjitha rekomandime e dhëna.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**përsërit se komisioni për verifikimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, nuk është legjitim për dy arsye dha atë se njëri nga anëtarët e tij është në konflikt të interesit ndërsa tjetra është se në vendim të kuvendit nuk është cekur çështja e parkut industrial që duhet të trajtohet (nuk kanë pasur kompetencë). Eleborimi i parafolësit lenë për të dëshiruar për saktësinë dhe të vërteten e këtij raporti. Në këtë lëndë –raport nuk është përfshirë opinioni i MAPL që ka vlerësuar pozitiv dhe të ligjshëm vendimin për dhënien e pronës

në shfrytëzim në Parkun industrial në Lumadh. Më tej e paralajmëroj parafolësin se në bazë të nenit 286 të Kodit Penal të Kosovës, vepra penale: komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar ku përkufizohet me sa vijon: Kushdo që në shkelje të detyrave të tij për ruajtjen e sekreteve afariste apo tregtare, ia kumton apo ia përcjell personit tjetër të dhënat lidhur me sekretet afariste apo tregtare ose në ndonjë mënyrë tjetër ia mundëson ndonjë personi të paautorizuar qasjen në të dhënat e tilla ose mbledh të dhëna të tilla me qëllim që t'ia përcjell personit të paautorizuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Po ashtu kufizimi e në zbulimin dhe komunikimin që e bëri parafolësi janë të ndaluar edhe me Ligjin për Qasje në Dokumentet Zyrtare, andaj për të gjitha këto shkelje e paralajmëroj parafolësin z.Bekim Zabergja se do të ballafaqohet me kallëzim penal, për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Tutej shtoj se shpjegime e bëra në këtë raport në kuvend janë me motive të ulëta dhe për qëllim dhe matematika tjera të dikujt nuk i bëjnë nderë askujt dhe janë tendencë për të vë kuvendin në lajthitje. I informoj qytetarët se projekti i zonës ekonomik në Lumadh është projekti më i madh në historinë e Vushtrrisë, kur priten të investohen rreth 23 milion euro në infrastrukturën ndërtimore dhe sipas planeve të biznesit shuma e përfitimit për komunën e Vushtrrisë ka qenë marramendëse, ku janë kontraktuar të hapen rreth 830 vende të reja të punës. Lidhur me keqpërdorimet eventuale që pretendohet është mirë të merren organet e drejtësisë, dhe përsërit se vendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim është vlerësuar ligjor dhe i plotfuqishëm nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Andaj tendenca që përmes dokumenteve të kontrabanduara të vihet në lajthitje kuvendi dhe opinionin qytetar është e ulët dhe nuk i bënë nder askujt.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**përsërit se është fat i madh që i gjithë dokumentacioni për zonën ekonomike ekziston, edhe jashtë komunës d.m.th në organet e drejtësisë, dhe në këtë rast shumë lehtë vërtetohet se këto konstatime të komisionit për verifikimin e pronës janë të pa bazuara dhe të pa vërteta. Tutje shtoi se pse ky komision nuk ka procesverbal të takimeve të tyre, kur i kanë mbajtur takimet, çka është diskutuar në ato takime, pse nuk i kanë sjell procesverbalet e takimeve nëse ato ekzistojnë. Pse nuk ka protokoll me të cilin ata i kanë marrë dokumentet nga drejtoritë gjegjëse. Mandej pse nuk është cekur fakti se nuk ka pasur ankesa ndaj punës së komisionit të më hershëm. Në fund ceku se komisioni vlerësues e ka kryer punën e tij ku ka sjell një rekomandim që është aprovuar në kuvend e për të cilin MAPL ka vlerësuar si të ligjshëm.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se në raport që e ka hartuar komisioni për verifikimin e pronës, sheshazi është evidentuar se ka pasur shkelje ligjore dhe kësisoj është për tu çuditur fakti se si kjo kontestohet. Njëra nga këto shkelje ligjore është që është konstatuar edhe nga institucionet relevante për konflikt interesi, ku ceket se abstenim i dy anëtarëve të kuvendit ka mundësuar kuorumin në vendimmarrjen në rastin e parkut industrial në Lumadh. Rasti i dytë është se ka përfitim të pronës nga familjarët e anëtarëve të komisionit e po ashtu përbën shkelje ligjore. Tutje vlerësoi dhe konkludoi se ka pasur shkelje të kritereve të konkursit sepse ata që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret nuk ka kanë përfituar pronë dhe kundërta. Në fund propozoi që ky projekt të kthehet në pikën zero dhe të ri hapet konkursit i ri për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe kësisoj të funksionalizohet ky projekt.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit**-tha se anomalia ekziston se ish- anëtari i komisionit për dhënien e pronës në shfrytëzim në parkun industrial z.Adnan Lahu, deklaron se dokumentet lidhur me këtë projekt ekzistojnë në institucionet tjera ndërsa në komunë nuk ekzistojnë dhe kjo është shumë e çuditshme dhe e paprecedent. Lidhur me paralajmërimin për kallëzim penal deklaroi se ai është në gjendje të jap përgjegjësi për çdo pikë të raportit që e ka hartuar, dhe njoftoi se

deklarimet e tij para kuvendit dhe përmendja e emrave të firmave apo operatorëve ekonomik e përfaqësuesve të tyre është bërë konform linjave dhe dokumenteve zyrtare.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**tha se është mirë që komisionet komunale që punojnë të marrin kompensimin e tyre, por për rastin e komisionit për verifikimin e pronës nuk duhet të ketë assesi pagesë pasi që është komision i kundërligjshëm.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-**në cilësinë e anëtarit të komisionit ceku se është i gatshëm që të japë përgjegjësi se kanë bërë punë të ndershme dhe profesionale, dhe duke ju referuar anëtarit të kuvendit z.Azemi, ceku se ai vazhdimisht mban ligjërata morale, por vet i shkelë ato parime në vazhdimësi, ai ka përfituar në kohen e Xhafer Tahirit dhe po përfiton edhe tani, mirëpo ky komision do të i'a ndaloj këto përfitime. Lidhur me pronat tjera që janë duke u vlersuar dhe verifikuar do të adresohen gjatë mbledhjeve të ardhshme. Kërkoj që raporti i tyre si komision të futet në votim për aprovim me të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**vlerësoi se të gjithë ata që merren me zonën ekonomike në Lumadh janë dashakeq për z.Ilmi Azemi, sepse ai po dihet se e ka interesin personal në këtë projekt. Tutej shtoi se komision është i ligjshëm dhe i ka kompetencat dhe autorizimet e plota nga kuvendit për ta trajtuar këtë çështje. Komisioni për të gjitha takimet ka mbajtur procesverbal dhe të njëjta i posedon dhe janë të protokolluara në Sekretarinë e Kuvendit. Për sa kohë është si anëtar i kuvendit asnjëherë nuk ka pasur raport më të kompletuar të ndonjë komisioni. Ajo për çfarë po e brengoset z.Azemi dhe disa anëtar të tjerë është prona dhe vlera e pronës që e kanë përfituar. Andaj ai si anëtar i LVV-së propozon që kjo çështje të kthehet në pikën zero, e po ashtu si komision por edhe si Lëvizje Vetëvendosje do ta dërgojnë këtë raport në organet e hetuesisë, në mënyrë që të zbardhet e vërteta. Lidhur me të gjeturat në raport për këtë çështje ceku se 5 biznese që nuk e kanë pasur të kompletuar dokumentacionin kanë përfituar pronë ndërsa 5 të tjera që e kanë pasur në rregull dokumentacionin nuk janë përzgjedhur si fituese të pronës, dhe kjo është shkelje flagrante, andaj kjo lëndë duhet të jetë objekt hetimi i organeve të hetuesisë.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**tha se deklaroi me përgjegjësi të plotë morale dhe juridike se 22 bizneset e përzgjedhura si përfituese të pronës në zonën ekonomike i kanë plotësuar të gjitha kriteret e konkursit në masën 100%. Mandej sqaroi se ndarja e sipërfaqes së pronës për bizneset është llogaritur konform kriterit për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit dhe sipas kërkesës për ngritjen e objektit biznesor të paraqitur në planin ideor. Në këtë proces nuk ka pasur asnjë ankesë nga subjekte që janë shpallur jo përfitues, që tregon se komisioni e ka kryer punën e vetë në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe më pas ka pasur vendimi për ligjshmërinë e aktit juridik nga MAPL-ja dhe ky kapitull ka përfunduar, janë nënshkruar kontratat dhe zbatimi i pronësisë tek operatoret ekonomik për 99 vite dhe tani është bërë edhe pranimi teknik andaj i fton bizneset që të aplikojnë për kushte ndërtimore sepse nuk ka rrugë tjetre nëse dëshirojmë zhvillim ekonomik.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se është i kënaqur që kishte propozuar formimin e një komisioni për verifikimin e pronës komunale që është dhënë në shfrytëzim, sepse kjo po rezulton se është bërë një punë e mirë për faktin se po dalin në shesh shumë informacione të rëndësishme lidhur me pronat komunale dhe shumë me rëndësi për proceset për ""Vushtrrinë që duam" për parkun industrial që duam dhe kjo tani po kuptohet se përse e kemi dashur aq shumë Vushtrrinë, sepse ky ishte një slogan-klishe e vjedhur. Sipërfaqja prej 14.86 hektar tokë të komunës të dhëna në shfrytëzim në parkun industrial, të dhëna në shfrytëzim nga një komunë që realisht ka mungesë të pronës publike për ta bërë edhe një lehë për mbjelljen e qepëve, dhe për këtë sot shohim heshtjen e shumicës së kuvendarëve e kjo nuk është në rregull sidomos prej anëtarëve të Partisë

Demokratike avangarde siç thuhej më herët. Është mirë të deklarohen prej kryetarit të komunës dhe anëtarëve të tjerë se a pajtohen me këtë çështje apo distancohen. Për të personalisht nuk është shumë më rendësi se kush është përfitues i pronës së atë zonë dhe mund të jenë ata edhe persona publik nëse i plotësojnë kriteret dhe kjo është në rregull dhe nëse gjeneronë punësim dhe zhvillim ekonomik dhe për këtë nuk mbajmë inate. Andaj shtoj dhe deklaroi se thirrja publike për aplikim për përfitim të pronës është ligj, dhe nëse ka pasur shkelje të thirrjes kemi të bëjmë me shkelje të ligjit dhe dikush duhet të përgjigjet. Nëse të gjitha këto janë të vërteta, atëherë ky projekt nuk duhet të kthehet në pikën zero, por i njëjti duhet të dërgohet në organet e drejtësisë për tu hetuar dhe për të nxjerr një epilog gjyqësor për këtë çështje. Nëse e kthejmë nëm pikën zero atëherë e lirojmë prej përgjegjësisë komisionin për këto shkelje që po pretendohen se janë bërë. Në fund përsërit se nuk ka peshë se kusht do të përfitoj në këtë proces, por duhet respektuar kushtet dhe kriteret ligjore, sepse sheshazi po del se ka pasur shkarje të madhe procedurale administrative dhe ligjore në tërë këtë proces, andaj duhet që kjo lëndë të procedohet në organet e drejtësisë të merret verdikti final dhe të ecim tutje.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se ky dokument apo kjo lëndë tregon se ka një lidhje mes politikës bizneset dhe zyrtarëve që se bashku mund ta quajmë si krim ekonomik, e që ka ekzistuar që moti dhe që e shkatërruar për brenda këtë shoqëri dhe këtë shtet. Mandej pyeti se e kemi një auditor të brendshëm të komunës i cili merr  një pagë jashtëzakonisht të lartë për rrethanat tona, dhe pyetja qëndron se a ka bërë ai ndonjë auditim për këta 15 hektar tokë të komunës. Andaj shtoj se në këtë proces ka shumë shkelje dhe ceku se duhet të suspendohen të gjitha vendimet lidhur me këtë projekt deri sa të merret verdikti i organeve të drejtësisë.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit**-sqaroi se shkelja tjetër në këtë çështje është se është bërë shpallja e konkursit para se të bëhet pranimi teknik i këtij projekti dhe ka pasur shkelje sa i përket kotzimit me pikë për bizneset përfituese si dhe mungesa e plotësimit të kushteve sa i përket dokumenteve për aplikim. Andaj kërkoj  nga kryesuesja e kuvendit që të hedhet në votim raporti i komisionit bashkë me rekomandimet e dhëna në raport dhe gjithë dokumentacionin përcjellës, ashtu që të shfuqizohet vendimi i cili është objekt shqyrtimi me numër protokolli 81/22 i datës 16.04.2021.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**kërkoj që para se kjo pikë të votohet ata anëtarë të kuvendit që kanë konflikt interesi në këtë çështje të lëshojnë sallën e mbledhjes.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se ky projekt është dashur të përfundoj në mandatin e kaluar, por meqë Agjencia Kundër Korrupsion ka gjetur se ka pasur konflikt të interesit tani kjo çështje ndodhet në një stad tjetër të shqyrtimit, pasi që në opinionin e Agjencisë  Kundër Korrupsion thuhet se pezullohen të gjitha dhe vendimet dhe të gjitha aktivitet në pakun industrial në Lumadh, deri në një vendim të ardhshëm. Ajo çka është më rëndësi është fakti që si kuvend këtë lëndë ta adresojmë në organet e drejtësisë dhe atje kjo çështje të spastrohet në tërësi. Qëndrimi i PDK-së ka qenë që të mos merret vendim deri në pranimin teknik të këtij projekti, i cili është bërë në maj të këtij viti dhe kjo nuk ka qenë e rastësishme. Pastaj shtoi se në këtë proces ka pasur keqpërdorime të skajshme dhe për më keq ka prej atyre keqpërdoruesve që edhe sot tentojnë të keqpërdorin me këto vendime dhe ky kuvend këtë duhet ta ndaloj. Pavarësisht insistimit të komisionit për ta kthyer në pikën zero këtë projekt, nuk duhet ti bëhet kjo e mirë atyre që kanë keqpërdorur sepse nëse kjo ndodh dikujt do ti krijohen favore, andaj lëreni kështu të pezulluar këtë vendim, mirëpo le të ketë deklaratë prej këtij kuvendi sepse nuk është e logjikshme e as e moralshme që nesër të thuhet Ferit Idrizit,  si kryetar komune e ka bllokuar procesin dhe ke penguar

832 vende të reja të punës dhe i ke ndal 20 milion euro investime, jo ne jemi për investime të reja dhe do ta hapim derën për secilin investitor që vjen në Vushtrri. Në këtë projekt vepra penale është kryer, dhe për këtë kallëzimet penale janë dorëzuar por sa do të veproj hetuesia dhe prokuroria këtë nuk e di. Lidhur me kushtet ndërtimore në projektin e Parkut Industrial, kuvendi duhet pasur një qëndrim sepse përderisa kemi një vendim të pezulluar, nuk duhet krijuar rrethana që dikush të shkoj në përgjegjësi nga Drejtoria e Urbanizmit pikërisht për këto gjëra. Pavarësisht gjitha këtyre zhvillimeve nuk duhet të përçohet mesazhi se ne jemi kundër bizneseve por duam të kemi ligjshmëri dhe të vejmë rend në këtë proces. Më tej deklaroj se në këto dhe zhvillimet e më hershme lidhur me këtë projekt është përmendur emri i tij për qëllime të etiketimit publik dhe linçimit gjoja që Kompani 7 vëllezërit në emër të Shpëtim Zhegrovës që ka përfituar pronë por kjo nuk ka qenë e vërtet dhe pikërisht në këtë pronë kanë ndodhur keqpërdorimi dhe fatkeqësisht anëtarët e komisionit e kanë bërë këtë. Në fund tha se edhe kontratat inerten që janë bërë do të dalin në sipërfaqe, dhe si qeveri komunale janë të interesuar që procesin e dhënies të pronës komunale në shfrytëzimi në parkun industrial të bëjmë plotësisht transparentë që në një sallë të hapur të merret vendimi duke u respektuar ligji dhe kriteret.
**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-** tha se kjo pikë e rendit të ditës duhet të kaloj vetëm si informatë për deri sa të jepet mendim prej organeve të drejtësisë dhe kjo kush ka bërë keqpërdorim le të jap përgjegjësi.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se duhet të nxjerrët një vendim për pezullimin e vendimit të më hershëm për parkun industrial, sipas opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, sepse kjo është obliguese.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se në këtë mbledhje duhet të merret një vendim, për çështjen e raportit që ka ofruar komisioni për verifikimin e pronës së paluajtshme, qoftë duke i pezulluar apo zhvlerësuar të gjitha vendimet e mëhershme për Parkun Industrial në Lumadh, dhe çështja të kaloj në organet e drejtësisë.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se nëse merret për bazë raporti i komisionit për verifikimin e pronës, atëherë kjo çështje duhet të kthehet në pikën zero, dhe të shpallet thirrja e re por kjo nuk mund të bëhet pa u prishur kontratat, por kjo është në formë tjetër dhe do të stërgjatët procesi.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se për këtë çështje është ngritur një komision i cili ka pasur legjitimitet të plotë sepse ka marr mandatin nga kuvendi. Tutje shtoi se a ka qenë dëshira e tij për tu marr me këtë çështje jo, dëshira e tij ka qenë që në atë zonë tash të operojnë bizneset. Në këtë proces janë tri të gjetura ndër kryesoret që janë nxjerr nga institucionet kredibile e para se është dhënë në shfrytëzim prona pa u bërë pranimi teknik i parkut industrial, e dyta kur është votuar ky projekt në kuvend është identifikuar konflikti i interesit dhe e treta kontrata me operatoret ekonomik janë lidhur plotësisht në kundërshtim me Ligjin për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim. Raporti i komisionit për verifikimin e pronës është hartuar mbi fakte që i ka gjetur gjatë shqyrtimit të dokumentacionit. Tani në këtë situatë një gjë nuk duhet të mendohet që të merret vendimi për kthimin në pikën zero sot dhe shpallet menjëherë konkursi kjo nuk mund të ndodh, sepse ky problem nuk zgjidhet me vendime politike, por me mjete dhe procedura juridike. Kontratat që janë nënshkruar mes komunës dhe operatorëve ekonomik janë ligj për palët dhe për komunën tonë shkaktojnë pasoja juridike, ato kontrata mund të bien poshtë vetëm me pajtimin e dy palëve apo mes kontestit të zgjedhur në gjykatë. Në këtë relacion duhet të gjendet një zgjidhje juridike, ndërkaq duhet pritur që organet e drejtësisë ta kryejnë punën e tyre. Kjo duhet të jetë mësim për të

gjithë kryetaret e komunave që do të vinë në ardhme që mandatin politik nuk mund ta shndërroj në mandat ligjdhënës që vet ti përcaktoj rregullat veti ti shkruaj dhe vetë ti nënshkruaj ato. Në fund tha se bashkërisht duhet ta gjejmë një zgjidhje oportune juridike e cila i shmang pasojat për komunën tonë duke e ruajtur gjithherë interesin e përgjithshëm qytetar dhe atë të komunës, zgjidhje të shpejt e të thjeshtë nuk ka sepse ekzistojnë kontrata mes palëve që janë ligj për to, por duhet të pritet që organet e drejtësisë ta japin vendimin e tyre, ndërsa ne duhet ta pezullojmë këtë vendim që të shmanget pak a shumë konfliktit i interesit që ka ekzistuar në vendimmarrje.
**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-**në rekapitullimin e debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës pas konsultave mes grupeve kuvendare konstatoj se janë ra në ujdi me sa vijon: që lidhur me pikën e Parku Industrial në Lumadh, kuvendi ti adresohet organeve të drejtësisë, pastaj duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale neni 83 kërkesë për konsultim paraprak për situatën që jemi do të kërkojmë nga MAPL të na japë opinion për këtë çështje, si dhe në bazë të opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, të pezullohen të gjitha vendimet dhe aktivitet deri në një vendim tjetër të kuvendit të komunës.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim pezullohet vendimi i Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.81/21 i datës 16.04.2021 për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës, ashtu që pezullohen të gjitha aktivitetet në Parkun Industrial (projektit Zona Ekonomike në fshatin Lumadh), deri në një vendim tjetër të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke marrë për bazë opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

2. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë do t’i njoftojë organet e drejtësisë me shkresat e lëndës që lidhen me çështjen e projektit Parku Industrial në fshatin Lumadh.

3. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë do t’i drejtohet me shkresë zyrtare Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal për të marrë opinion ligjor (konsultim paraprak) lidhur me çështjen e Parkut Industrial në fshatin Lumadh.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Kryesuesja e kuvendit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe drejtoritë tjera komunale që lidhen me domenin e kompetencave me çështjen e Parkut Industrial në Lumadh.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**12.** Shqyrtimi i Raportit i komisionit të kuvendit të komunës lidhur me verifikimin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim në fshatin Stanoc i Epërm;

**Lulzim Berisha, përfaqësues i kompanisë së tekstilit Vitex-** konform rregullores së punës të kuvendit mori fjale duke prezantuar të dhëna për biznesin e tyre, dhe duke e kundërshtuar raportin e komisionit komunale lidhur me këtë çështje. Kërkoj nga ana kuvendit që këtij operatori ekonomik ti vazhdohet kontrata për vazhdimin e zhvillimit të veprimtarisë afariste.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**në cilësinë e kryesuesit të komisionit prezantoj para kuvendit raportin e komisionit si në vijim: Komisioni duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës

së Vushtrrisë Nr. 125/22 dt. 26.05.2022 ku është kërkuar verifikimi i procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, verifikimi i dokumentacionit, investimet e bëra nga investitori dhe kontratat e punëtorëve, komisioni ka zhvilluar takime dhe së bashku kanë trajtuar dokumentacionet përkatësisht kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të dt. 05.03.2021 me nr. protokolli 211/21 përkatësisht ish objekti i shkollës fillore “Migjeni” në Stanoc të Epërm.

Takimi i parë i komisionit është mbajtur me datë 10/06.2022, ku të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Në këtë takim Faton Hyseni, u zgjodh kryesues i komisionit ndërsa Fortuna Krasniqi, u zgjodh proces-mbajtëse.

Me datë: 10/06/2022 rreth orës 14:30, vizituam ish objektin e shkollës fillore ‘’Migjeni’’ në Stanoc të Epërm dhe konstatuam se:

1. Kompania ‘’Vitex Group” SH.P.K – kishte të angazhuar 10 punëtorë prej të cilëve 3 punëtorë (2 burra dhe 1 grua), ishin staf menaxhues kurse 7 punëtore ishin duke punuar në makina qepëse.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 3, pika 3.1.2 të kontratës të nënshkruar nga Komuna e Vushtrrisë dhe kompania “Vitex Group” e datës 05/03/2021, ku thuhet: Kompania “Vitex Group” do të krijojë fillimisht 35 deri 50 vende të punës, ndërsa në perspektivë edhe më tepër vende pune, kurse me rastin e përurimit të kësaj fabrike me datë 14/10/2021 thuhet se do të punësohen 60 gra.

2. Menaxheret e kompanisë nuk na ofruan qasje në dokumentacion të kompanisë e as në kontratat e punëtoreve me arsyetimin se nuk është prezent pronari i kompanisë.
3. Objekti brenda është rinovuar (fasaduar), me fasadë dhe glet.
4. Gjatë renovimit të objektit janë rrënuar muret e brendshme të dhomave dhe hapësirave të tjera që bie në kundërshtim me nenin 3, pika 2.2 të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet se kompania “Vitex Group” nga Prishtina merr përsipër që objektin në shfrytëzim ta rinovoj para fillimit të veprimtarisë biznesore pa pasur të drejtë për ta ndërruar në esencë strukturën e dhomave dha hapësirave të tjera në kuadër të objektit të cilin e merr në shfrytëzim. Po ashtu në objekt nuk ekziston fare ngrohja qendrore e cila ishte e instaluar vite më parë si donacion nga qeveria Japoneze në vlerë rreth 70.000,00 euro gjithashtu është prishur salla e mësimdhënësve, zyra e drejtorit, salla e punëtorëve teknik, kabineti i informatikës, vendi ku qëndronte kaldaja, banjat janë demoluar dhe është hedhur BINA e cila dikur ishte në korridor të shkollës.

Pasi që me datën 10/06/2022, nuk na është ofruar dokumentacioni i kompanisë “Vitex Group” e as kontratat e punëtorëve ne si komision u dakorduam me menaxheret e fabrikës qe të takohemi me datë 13/06/2022 rreth orës 08:00, dhe ata na premtuan që do e sjellin dokumentacioni qe ne e kërkuam. Me datë 13/06/2022, rreth orës 08:20, tre (3) anëtarë të komisionit: Faton Hyseni, Ymer Haradinaj dhe Mensur Kosumi (munguan Fortuna Krasniqi dhe Shqiponje Mikushnica), shkuam në objektin e kompanisë dhe takuam vetëm njërin nga menaxheret e kompanisë i cili prape nuk na e ofrojë dokumentacionin e kërkuar. Atë ditë pra me datë 13/06/2022 në fabrike nuk kishte asnjë punëtorë/e me arsyetimin se është festë. Pas refuzimit të dhënies së dokumentacionit nga ana e menaxhmentit të kompanisë “Vitex Group” ne si anëtarë të komisionit shkuam në Komunën e Vushtrrisë ku morëm kontratën për dhënie në shfrytëzim të ish objektit të shkollës fillore “Migjeni” në Stanoc të epërm të nënshkruar nga ish Kryearti i Komunës së Vushtrrisë dhe pronari

i kompanisë “Vitex Group” e ku specifikohej se kjo kontratë është në afat kohorë prej 11 muaj e 25 ditë, që do të thotë se ky afat ka skaduar nga data 01/03/2022. Në të njëjtën ditë pra më datë 13/06/2022, vizituam ATK-n në Mitrovicë, ku takuam drejtorin e ATK-së z. Besim Halili, nga i cili morëm informatën zyrtare rreth biznesit “Vitex Group”. Në informatë thuhet: biznesi “Vitex Group” LLC me numer biznesi 811471953 është i regjistruar me 26/10/2020 si SH.P.K Në bazë të gjendjes së tij në ATK del se gjatë vitit 2021 nuk ka ushtruar veprimtarinë e tij me që qarkullimi i tij është deklaruar me zero, po ashtu nuk ka të paraqitur fare punëtorë gjatë këtij viti. Nga janari i viti 2022 ka të lajmëruar 15 punëtorë për të cilët ka deklaruar në ATK dhe për të cilët nuk ka paguar tatim në paga si dhe kontribute pensionale.

**Konkluzionet:**

1. Kompania “Vitex Group” Sh.p.k nuk i ka përmbushur kushtet e kontratës.
2. Kontrata në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe kompanisë “Vitex Group” Sh.p.k ka skaduar më 01.03.2022.
3. Komuna e Vushtrrisë nuk ka kurrfarë obligimi ndaj kompanisë “Vitex Group” Sh.p.k.

Pas vlerësimit të të gjeturave dhe vizitës në terren në bazë të cekurave më lartë, komisioni jep këto rekomandime:

1. I rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të ndalojë çdo procedurë për vazhdimin e kontratës me kompaninë “Vitex Group” Sh.p.k
2. T’i ipet një afat i arsyeshëm ligjor kompanisë “Vitex Group” Sh.p.k për largimin e pajisjeve dhe lirimin e objektit që e kishte në shfrytëzim.
3. I rekomandojmë Drejtorisë së Arsimit që të bëjë analizën e numrit të familjeve me fëmijë të moshës 1-6 vjeç në atë zonë me qëllim të inicimit të procedurave për planifikimin dhe ndërrimin e destinimit të objektit në Çerdhe-Kopsht sipas nevojës dhe të parasheh planifikimin e buxhetit për rikonstruim për vitin 2023.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-tha se është e vërtet që në disa pika qiramarrësi i kësaj prone nuk i është përmbajtur kontratës, që ka qenë kontratë njëvjeçare, por duhet pasur parasysh që këto kohë ka mbizotëruar një kohë e krizës globale që ka prekur çdo sektor të jetës. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, vlerësoi se është fat i madh që bizneset vinë në Vushtrri dhe operojnë këtu tek ne në zhvillimin ekonomik. Aspektet teknike të punëtorëve do të mund të rregulloheshin nga ana e kompanisë, dhe mendon se do të ishte e udhës që mos ti ndërpritet veprimtari dhe puna këtij biznesi. Sa i përket çerdhes mendon se në atë lokalitet ka nevojë për një të tillë dhe kjo mund të planifikohet në buxhet që në atë hapësirë afër shkollës të ngrite ajo. Propozoi që të gjendet një modalitet që përmes kuvendit ti jepet në shfrytëzim kjo pronë në afat më të gjatë këtij operatori ekonomik.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**vlerësoi se procesi dhënies në shfrytëzim të pronës të ish-objektit të shkollës “Migjeni” në Stanoc të Epërm, nga ish kryetari i komunës është zhvilluar me shumë parregullsi, dhe duke anashkaluar çdo procedurë ligjore që është e paraparë. Fillimisht nuk është mbajtur diskutim publik me banorët e lokalitetit ku është bërë kjo fabrikë, lidhur me këtë çështje, më tej nuk është konsultuar këshilli i fshatit dhe qytetarët e Stanocit të Epërm. Përpjekja e tyre ka qenë që të vendosën në lokalitet tjera mirëpo duke e parë pozicionin politikë të dobësuar të ish kryetarit të komunës, me një vendim politikë ai ka vendos që ish objektit i shkollës

“Migjeni” në sipërfaqe prej 910 $m^2$ të ia jep një kompanie me shumë të panjohura e cila ishte regjistruar si biznes vetëm disa muaj më parë. Si pasoj e kësaj erdhi reagimi qytetar, duke ushtruar një peticion që iu bashkëngjiten mbi 500 qytetar, në këtë kontekst ishte kërkuar që pronarët e kësaj kompanie të mirëkuptojnë që të shkojnë në ndonjë lokalitet tjetër për ta ngritur këtë fabrikë, për shkak se objekti i shkollës “Migjeni” do shfrytëzohej për çerdhe publike. Në këtë rrjedh ka pasur edhe protesta të banorëve, dhe me gjithë këto zhvillime pronaret e kompanisë në bashkëpunim me kryetarin e komunës dhunshëm kanë hyrë në këtë objekt. Lidhur me këtë çështje vazhdimisht ka pasur kërkesa nga banorët e këtij lokaliteti që ky objekt të jetë ashtu siç ka qenë objekt edukativo-arsimor. Nuk jemi kundër punësimit por jemi kundër ekonomisë-informale dhe veprimtarive jo legale biznesore. Nga raporti me të gjeturat që është bërë nga komisioni del se kjo kompani është ilegale dhe informale sepse nuk ka të punësuar sipas ATK-së dhe e njëjta ka shkelur kontratën që është lidhur mes saj dhe komunës. Në kontratë është thënë se do të punësohet 60 punëtor, çka një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ajo se çfarë ka ndodhur është demolimi i atij objekti dhe asgjë më tepër. Mandej shtoj se nuk është e vërtet se ish-objekti i shkollës është marrë në gjendje të mjerueshme sepse vetëm disa muaj më herët aty kanë mësuar fëmijët tanë, por në gjendje të mjerueshme është sjellë nga kjo kompani e cila ka bërë demolimin e mureve. Infrastruktura publike ajo e ujësjellësit dhe kanalizimit ka qenë e kyqyr në shkollë edhe më herët dhe nuk është bërë nga ana e kësaj kompanie. Pretendimi se janë punësuar 20 gra nuk është i vërtet dhe kjo mund të vërtetohet nga ATK-ja, sepse në vitin 2021 kjo kompani nuk ka pasur të regjistruar asnjë punëtor, për më keq aty punojnë njerëz të kategorisë së dala nga lufta që kanë dëmtuar dhe hendikepuar e që kjo paraqet shkelje ligjore dhe për këtë do të alarmohen edhe organet kompetente. Në fund shtoj se duke marrë për bazë interesat dhe kërkesat e qytetarëve të atij lokaliteti, peticionin, rekomandimet e komisionit kërkoj nga kryetari i komunës që kësaj kompanie të mos i vazhdohet kontrata.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se është për keqardhje niveli i përgjegjësisë të institucioneve komunale lidhur me këtë rast, pasi që ka pasur një vit kohë në dispozicion për ta zbardhur këtë rast në tërësi. Lidhur me këtë çështje kërkoj opinionin e kryetarit të komunës pasi që është i pari në qeverisjen dhe drejtimin e komunës. Pasi ka të gjetur për ekonomi informale dhe punësim të rasteve sociale, atëherë pyeti se cilat janë masat që ka ndërmarr Drejtoria e Shëndetësisë për evidentimin e këtyre rasteve dhe zgjidhjen e tyre. Pastaj për mos përmbajtje të kontratës cilat janë veprimet e drejtorive përkatës lidhu me këtë problematikë, cilat janë qëndrimet dhe rekomandimet e kryetarit pas takimit me përfaqësuesit e kësaj kompanie. Për më keq ku janë përfaqësuesit e PDK-së përse e kanë lëshuar mbledhjen a ka ndonjë qëllim në këtë çështje. Andaj kjo ikje nga përgjegjësia tregon se nuk jeni të gatshëm si parti në pushtet ta materializoni vullnetin qytetar që e keni marr në zgjedhje dhe kjo do të vjen koha kur qytetari do ta revokoj vendimin e tyre për besimin që iu ka dhënë.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se ai nuk i ndan qytetaret e komunës në parti politike sepse është kryetar i të gjithë qytetarëve dhe përsërit sloganin e tij se <99 fije i ka të lidhura me qytetarin e 1 fije me partinë që e përfaqëson>, dhe shtoj se këtë deklaratë do të dëshironte ta dëgjonte edhe nga kryetari i LVV-së në Vushtrri z.Meholli. Tutje duke dhënë një elaborat lidhur me problematikën shtoj se është dashur të kesh një guxim të madh kur kompania brenda një viti, ka vendosur të bëj një investim kaq të madh në shkollën “Migjeni” të shndërruar në fabrikë dhe kjo është çështje në veti. Pastaj kontrata ka skaduar me datën 1 mars 2022 dhe prej kësaj date qëndrimi në atë objekt nga aspekti juridik është ilegal. Menjëherë pasi ka marr mandatin si kryetar i komunës ka qenë i vëmendshëm dhe ka marrë veprime, por kanë dal problem në teren sepse me të marr

listën poseduese del se prona në atë shkollë është e AKP-së në pronësi shoqërore, nuk është pronë e komunës. Në anë tjetër po të kishte mundësi do ta ndihmonte këtë kompani për ta realizuar veprimtarin e tij në masën 100 %, dhe këta nuk do të kishin pasur kurrë nevojë të vijnë në seanca të kuvendit sepse do ta kryente dhe zgjidhte këtë problem. Ajo kontratë është dashur të bëhet për së mbari duke caktuar një mbikëqyrës të kontratë dhe duke ndjekur në përpikëri zbatimin e saj. Në vazhdim sqaroi se prona në atë objekt nuk është komunës dhe si kryetar i komunës nuk ka të drejt të nënshkruaj por kuvendi do të mund ta autorizonte atë që të hapë një dritare të negociatave me këtë kompani. Në këtë kontekst vlerësoi se për çdo cent që ka investuar kompania ka ndjeshmëri por ai nuk mundet të merr përgjegjësi të nënshkruaj diçka që ka të meta juridike dhe më pas të shkaktoj pasoja për veten dhe për komunën. Mandej për ta bërë transparente këtë çështje e kishte pyetur përfaqësuesin e kompanisë në takimin që kanë pasur se a e ka lexuar kontratën që nuk ka pasur të drejt të bëj rrënimin e mureve të brendshme të objektit , apo ndoshta ish-kryetari i komunës e ka nxitur që të bëj një gjë të tillë sepse ka menduar se do ti fitoj zgjedhjet dhe do të vazhdonte veprimtarinë ky subjekt ekonomik. Në fund kërkoj nga zyrtarët ligjor që të japin mendim lidhur me të drejta dhe obligimet që ka kjo kompani në këtë çështje.
**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore-**sqaroi se në kuvend nuk ka se çfarë të diskutohet sa i përket kontratës sepse ajo ka përfunduar, a është përfillur kontrata e vjetër është çështje e organeve komunale që është dashur ta përcjellin zbatimin e saj, dhe ato mbajnë përgjegjësi se përse nuk e kanë mbikëqyr. Pastaj shtoi se konkludoi se është kontestuese definimi i pronësisë së kësaj prone, sepse prona është në emër të AKP-së, dhe më vonë ajo do të mund ta shiste këtë pronë, atëherë çfarë do të bënim ne me këtë kompani. Në të kundërtën nëse nuk do të kishte dilema sa i përket pronës atëherë kryetari i komunë në bazë të ligjit ka të drejt të zhvillonte negociata me këtë kompani. Në këtë kontekst vlerësoi se nëse del se komuna ka inertes për atë pronë do të mund ti drejtohej me një kërkesë AKP-së për të marr aprovim se për sa vite mundet ta japë atë objekt në shfrytëzim me të drejtën e kalimit nëpër pronë e AKP-së.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit**-tha se sa i përket pronësisë në rastin e objektit të shkollës në Stanoc të Epërm nuk ka dilema sepse objekti i shkollës është në pronësi të komunës, ndërsa toka është në pronësi të AKP-së. Por për të gjetur një zgjidhje afatgjate duhet të kemi negociata mes AKP-së, kryetari të komunës dhe operatorit ekonomik për ta shmangut privatizimin e asaj prone dhe kështu ti jepet hapësirë operatorit ekonomik për ta vazhduar veprimtarinë e tij afariste.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se lidhur me këtë çështje për pronën e ish-objektit të shkollës "Migjeni" mandatin e kaluar kishte votuar pro, dhe çdoherë do ta bënte këtë me qëllimin më të mirë për ti ofruar kushte bizneseve në komunën tonë. Por çdo ditë që po shqyrtojmë tema nga mandati i kaluar po dalin në sipërfaqe kontrata e dëmshme për komunën që janë lidhur në mandatin e kaluar, në rastin konkret në dëm të komunës por edhe të kompanisë. Në atë kohë fatkeqësisht askush nga kuvendi i atëhershëm nuk ka pasur informata që kjo pronë nuk është e komunës dhe për më keq sot këtu e kemi anëtarin e kuvendit z.Adnan Lahu që ka qenë drejtor i Kadastri dhe nëse ky i fundit e ka ditur se ajo pronë është e AKP-së, dhe nuk ka dhënë këtë informacion d.m.th ka heshtur kjo është shumë e rënd, sepse është dashur të njoftohen anëtarët e kuvendit dhe për më tepër është dashur të njoftohet kompania që mos të investoj sepse nuk ka siguri në atë kontratë dhe anëtarëve të kuvendit është dashur tu jepet informata që po votojnë për një rekomandim për lidhje kontrate për një pronë që në fakt nuk është e komunës dhe kjo është tepër e rënd. Sot në këtë situatë të krijuar nuk është e lehtë për asnjë anëtar të kuvendit të votoj një raport-rekomandim për shkëputjen e një kontrate me një kompani që ka investuar 100,000.00 €.

Në këto rrethana shtroj hipotezën çka nëse sot këtë pronë e japin në shfrytëzim për 99 vite dhe më pas AKP e qetë në privatizim këtë pronë dhe në fund obligimet dhe dëmet i bartë komuna. Në rastin konkret këtu duhet dhënë sqarime ish-drejtori i Kadastri z.Lahu edhe në cilësinë e kryesuesit të komisionit për dhënien e pronës në shfrytëzim sepse nëse është leshura lista poseduese dhe kopja e planit për një pronë që nuk ka qenë pronë e komunës janë vu në lajthitej anëtarët e kuvendit dhe është manipuluar Kompani Vitex Grop në rastin konkret dikush duhet të jap përgjegjësi dhe ai sot ka pritur që në këtë seancë të jenë prezentë edhe instancat tjera të shtetit ato të drejtësisë për ta parë me zë e figurë këto zhvillime mjaft të rëndësishme dhe të rënda për komunën. Andaj në këtë moment të gjithë gjendemi në një situatë tepër të vështir sepse anëtarët e kuvendit e kanë të vështirë të votojnë për diçka që ka të bëj me mbylljen e një kompanie, por duhet kuptuar edhe kompania që ka bërë investime dhe tani po i shkëputet kontrata dhe pozita aspak e lehtë e kryetarit aktual të komunës i cili nuk ka mjete në duart e tij për dhënë zgjidhje kësaj problematike. Në fund tha se komisioni ka bërë një punë të mirë dhe sjell raportin me të gjeturat sipas dokumentacionit dhe fakteve që i ka shqyrtuar.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se në kohen kur ka qenë Drejtor i Drejtorisë së Pronës, çdo informacion që është kërkuar nga kuvendi apo ndonjë organe tjetër ai informacion është ofruar. Lidhur me kontratën që po përfolët atë e ka lidhur kryetari i komunës, dhe edhe në të kaluarën por edhe tanë është praktikë e keq që po tentohen të kamuflohen proceset e pronës përmes kuvendit. Andaj anëtaret e kuvendit nuk kanë asnjë lloj detyrimi për këtë kontratë sepse atë e ka lidhur ish-kryetari i komunës për afat më pak se 1 vjet, nuk e cakton kuvendi i komunës lidhjen apo shkëputjen e kontratave në aspektin ligjor ne nuk e kemi këtë autorizim. Kuvendi i komunës i voton listat për dhënien e pronës në shfrytëzim, formon komisionin e pronës, komisioni e sjell një rekomandim dhe tutje vazhdon ekzekutivi, pra nuk është kompetent kuvendi as me lidh e as me prishë kontrata dhe pyeti se përse është sjell ky material sot në këtë mbledhje kënd po dëshirojnë ta fajësojmë. Sa i përket pronave tjera e dini krejt Vushtrria se Gjimnazi aktual i Vushtrrisë është ndërtuar në tokë të AKP-së dhe kjo është bërë nga ish pushteti i PDK-së në Vushtrri. Në fund tha se këtë pikë nuk kanë nevojë fare ta voton kuvendi i komunës sepse kompetencat e kuvendit dhe ekzekutivit janë të ndara.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se nuk tendencë të atakon askënd, por vërtet këto tema që po shtjellohen janë pasoj e veprimeve të dëmshme nga qeveria e kaluar. Lidhur me çështjen e ndërtimit të gjimnazit në tokën e AKP-së sqaroi se në atë kohë ka ekzistuar një rregullore e UNMIK-ut që ka mundësuar shpalljen e zonës së interesit për komunën, dhe nuk janë paraqitur në këto raste problem në kompensimin apo këmbimin e pronës. Në rastet tjera ai nuk e di që kryetari i komunës mund të iniciojë dhënien e pronës në shfrytëzim pa mandat të dhënë nga kuvendi.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**njoftoi se në peticionin e banorëve të fshati Stanoc i Epërm për kundërshtimin e ndërtimit të fabrikës së tekstilit në objektin e shkollës “Migjeni” ka qenë i bashkangjitura certifikata pronësore dhe kopja e planit për pronën. Propozoi që të aprovohet raporti i komisionit së bashku me rekomandimet dhe të kompanisë ti jepet një afat prej 60 ditëve për largimin e pajisjeve nga ish-objekti i shkollës “Migjeni”.
**Melihate Basholli-Latifi- Kryesuese e Kuvendit-**në rezymenë e diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës konstatoj se e hedh në votim aprovimin e raportit të komisionit së bashku me rekomandimet, duke i dhënë një afat të arsyeshëm Kompanisë ’Vitex Group” SH.P.K, që ti largoj pajisjet nga ish-objekti i shkollës “Migjeni” në Stanoc të Epërm.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim aprovohet raporti i komisionit komunal për verifikimin e procesit të dhënies të pronës komunale në shfrytëzim, verifikimi i dokumentacionit, investimet e bëra nga investitori dhe kontratat e punëtorëve, lidhur me ish-objektin e shkollës fillore "Migjeni" në fshatin Stanoc i Epërm, i cili ishte dhënë në shfrytëzim me kontratën me numër të protokollit 02-Nr.211/21 e datës 5.3.2021 Kompanisë së tekstilit "Vitex Group".

**2.** Obligohet Drejtoria e Inspektimeve që në bashkëpunim me Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Vushtrrisë, që në një afat të arsyeshëm ligjor të ndërmarrë veprimet e nevojshme për lirimin e objektit të ish-shkollës fillore "Migjeni" ashtu që fabrika "Vitex Group" t'i largojë pajisjet nga objekti në fjalë.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Inspektimeve, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**13.** Shqyrtimi i Raportit i komisionit të kuvendit të komunës lidhur me konstatimin e gjendjes faktike të objektit në fshatin Pestovë, si dhe shqyrtimi i kundër peticionit lidhur me këtë çështje;

**Kjo pikë e rendit të ditës me vota unanime u shty për shqyrtim në ndonjërën nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit.**

**14.** Shqyrtimi i Raportit të punës nga grupi vlerësues për identifikimin e shtëpive – shkolla;

**Ymer Haradinaj ,anëtar i kuvendit-** tha se ka lexuar me vëmendje raportin e komisionit dhe ajo çka është interesante është fakti se nga 5 anëtar të komisionit vetëm 2 anëtar kanë dal të terren ,që është e pamjaftueshme sepse duhet qe se paku 50% e anëtarëve të komisionit, për të qenë informata e plotfuqishme ,megjithatë kam parë qe keni bërë një punë të mirë dhe keni identifikuar shumë shtëpi shkolla të viteve të 90-ta ,shumë mësimdhënës të cilët gjate asaj kohe e kane dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm . mendoj qe si raport është i papërfunduar, gjatë asaj kohe kame qene nxënës ,maturantë i vitit te 4-të ,nuk janë të përfshira shtëpitë shkolla të fshatit Stanoc i Epërm. Mësimi është zhvilluar në pesë shtëpi shkolla në këtë fshat ,tek Hamdi Prronaj ,Ismet Kasumi ,Rifat Maloku,Rraush Shala dhe Isak Kosumi. Po ashtu nuk janë të përfshira shtëpitë shkolla nga fshati Stanoc i Poshtëm dhe nga Lumadhi. Nuk është përfshirë edhe punkti i Pestovës sepse nxënësit kanë mësuar në Pestovë dhe në Maxhunaj. Ne Maxhunaj ka mësuar shkolla e Gjimnazit kurse në Pestovë shkolla e mesme Teknike. Po ashtu tek mësimdhënësit të cilët kane dhënë mësim në Maxhunaj mungon emri i profesorit të kimisë Gani Jashari ju kisha kërkuar të plotësohet. Kisha me i falënderuar të gjithë mësimdhënësit e asaj kohe në veçanti ata në Stanoc të cilët na kanë dhënë mësim ,veçojë tre prej tyre te cilët nuk janë me ne mesin tonë : Jusuf Hajredinaj,Sejdi Hyseni dhe Miran Shala. Kam propozime ne emër te Grupit te Lëvizjes Vetëvendosje, qe ju si komision qe jeni ne pajtim me qeverinë komunale dhe asamblenë komunale qe te gjithë mësimdhënësve te asaj kohe te ju ndahet nga një mirënjohje. Janë 250 mësimdhënës është respekt shume i madhe qe ju behet mësimdhënësve te asaj kohe.

**Sylejman Meholli anëtar i kuvendit:** tha, lidhur me evidentimin e shtëpive shkolla e përgëzoj komisionin për punën ,një dokument qe i kemi borxh arsimit dhe historisë ,prandaj është një

iniciative e mire. Dëshiron të plotësoj sepse secili nga ka informatë më shumë për regjionin nga vjen. Ne regjistrin e pronareve te shtëpive shkolla ose (odave). Numër 9 Ahmet Morina e liroj një dhome ,mirëpo e ka liruar oden komplet dhe shtëpinë ka qene i gatshëm ta liroj, të vlerësohet që ka liruar një odë(shtëpi) jo vetëm një dhomë.
**Galip Avdiu ,anëtar i kuvendit-** tha ,dhe para se te filloj seanca u konsultova me Ymerin dhe e kam parasysh qe fshatin Stanoc nuk e kemi përfshirë ,për shkak se nuk kemi pasur informacione. Jam bazuar ne hartimin e këtij raporti duke dal ne terren bashke me Profesorin Bedri dhe Fahri ,d.m.th kemi dal me shumë se 50% . Raportit do të ia bashkëngjisë edhe shtëpitë shkolla te fshatit Stanocë ,Lumadhë dhe kudo qe do te identifikojmë. Komisioni ka dhënë propozim qe jo te gjithë shtëpie te ju vendosen pllaka sepse janë ne raport 72 ,duke je bashkëngjitur dhe këto ne Stanoc mund te shkoj mbi 80. Komisioni ka propozuar qe shtëpitë shkolla qe kane kryer funksioni si shkolle 6 muaj e tutje me ju vendos pllaka ,ndërsa te gjitha me ju dhënë mirënjohje, e mbështes edhe propozimin tuaj qe edhe profesorëve qe kane dhënë mësim ne atë kohe te ju jepet mirënjohje.
**Ferit Idrzi, kryetar i Komunës-** falënderoj komisionin për punën që ka punuar ne këtë drejtim ,besoj qe do te kryejnë punën ashtu siç u është kërkuar. Mendoj qe komisionit duhet te ju jepet hapësirë por edhe materiale nga te gjithë, besoj qe deri ne seancës e fundit mund te përmbyllet, të dihet saktësisht. Propozimi për mësimdhënësit është shume me vend , ne kemi menduar qe data 7 marsi ,te jete dita kur i vendosim këto pllaka dhe ndajmë mirënjohje, dekorata. Kur te kompletohet raporti e miratojmë ne kuvend. Nuk e di një çështje ne këto vendimet e kuvendit nëse nuk është përfshirë kompensimi i anëtarëve te komisionit, kërkoj nga kryesuesja qe për seancës e radhës ,për te gjitha komisionet te vihet me plotësim të këtyre vendimeve ,vërtet po behet një punë shumë e mire të paktën një kompensim sipas legjislacionit ne fuqi.
**Ali Januzi ,anëtar i kuvendit-** tha ,e dëgjova parafolësin por propozimi nuk me pëlqeu, disa shtëpi me te vërtet kane mësuar mbi 6 muaj ,ne një shtëpi qe kane mësuar shembull 6 jave. Asaj qe kane mësuar 6 muaj qe ju vihet pllaka kurse kësaj qe kanë mësuar 6 jave te mos i vuhet pllaka, po mënoj qe nuk është mirë dhe nuk është e drejte. Po filloj nga UÇK-se aty ku kane qene shtabet qofte një muaj qene ose 2 jave ,aty është vendosur çdo kund nga një pllake ,edhet për këtë keni kujdes se mos po bëjmë ndonjë gabim , te këto familje kam frik se mos po futet ndonjë konfuzion. Edhe një herë propozoj qe çdo shtëpi qe është zhvilluar mësimi ne gjuhen shqipe pa marre parasysh sa kohe te vuhet pllaka.
**Melihate Basholli-Latifi kryesuese e kuvendit**: tha ,një falënderim i veçante për anëtaret e komisionit dhe ju dëshiroj pune te suksesshme edhe tani e tutje deri ne kompletimin e materialit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit me vota “unanime” aprovoj Raportin e punës nga grupi vlerësues për identifikimin e shtëpive – shkolla.**

**15.** Shqyrtimi i peticionit te banorëve të objektit banesor ne rr.” Dëshmoret e Kombit ”

**Bekim Zabërgja ,anëtar i kuvendit-** tha, ky peticion qenka ne lidhje me objektin banesor ku banoj, nga te tri drejtimet ka muzikë nga lokale te ndryshme ,shume herë i kam toleruar t’i le bizneset te punojnë sidomos gjate sezonës së verës kur ka me shumë qarkullim. Drejtorisë se inspekcionit po i drejtohem të jetë me vigjilente dhe t’i kontrolloj këto lokale qe janë afër.
**Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë së Inspektimeve-** tha, dua te ju informoj qe ligji për zhurmën i cili është ne kuadër te ligjit për mbrojtje të mjedisit i parasheh zhurmat qe vijnë nga industritë transporti ajror ,hekurudhor nuk parasheh zhurmë për zhurmë nga muzika. Zhurma është kompetencë e ligjit për prishjen e rendit dhe qetësisë publike, kështu që nuk është kompetencë e

inspektoratin me marr masa ndaj kësaj veprimtarie , ju kemi përgjigj me shkrim ankesës se qytetarëve duke u bazuar ne nen dhe ligj.
**Melihate Basholli-Latifi, kryesues e kuvendit-** tha, me qenë se nuk është ne kompetencë e inspekcionit ,ne po ju rekomandojmë si kuvend Policisë së Kosovës dhe po ju kthej përgjigjeje qytetareve që e kemi shqyrtuar peticionin e tyre ne kuvend.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: **29 shtator 2022,** konform obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ka shqyrtuar peticionin e banorëve të objektit banesor në rrugën "Dëshmorët e Kombit", të parashtruar në emër z.Turan Tunuzli, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për ndalimin e muzikës deri në orët e vona të natës, duke e prishur kësisoj rendin dhe qetësinë publike, andaj Kuvendi i komunës pas një analize të hollësishme, të lartcekurit i parashtron këtë:

**<u>Kërkesë</u>**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Stacioni Policor në Vushtrri që konfom legjislacionit në fuqi, të bëjë kontrollet e nevojshme në lokalet që prishin rendin dhe qetësinë publike, ashtu që banorët e objektit në fjalë të kenë qetësi në banesat e tyre.

**16.** Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Pasomë, lidhur me kushtet i infrastrukturës publike.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: **29 shtator 2022,** konform obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fshatit Pasomë "Lagjja Dauti" të parashtruar në emër z. Izet Jonuzit, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për inspektimin dhe parandalimin e disa operatorëve ekonomik që eksploatojnë shkëmbinj në atë zonë, në ç' rast nga pluhuri është vështirësuar jetesa e atyre banorëve, si dhe është dëmtuar infrastruktura publike, andaj Kuvendi i komunës pas një analize të hollësishme, të lartcekurit i parashtron këtë:

**<u>Kërkesë</u>**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Drejtoria e Inspektimeve, e Komunës së Vushtrrisë, që të ndërmarrë veprime konkrete, konform legjislacionit në fuqi, për inspektimin e gjendjes, parandalimin dhe evitimin e dëmeve të shkaktuara nga këta operatorë ekonomik, si dhe ndalimin e dëmtimit të mëtejmë të infrastrukturës publike.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, e merr për bazë peticionin dhe vlerëson se kërkesat e banorëve të fshatit Pasomë janë plotësisht legjitime, andaj konform mundësive buxhetore, komuna do t'i përfillë këto kërkesa, për rivitlaizimin e infrastrukturës publike në atë zonë.

**17.** Shqyrtimi i nismës për bashkëpunim ndër komunal ne mes te Komunës se Vushtrrisë dhe Komunës se Obiliqit**;**

- Nxënësja e grupit letrar "Gjimnazisti", Flutura Hyseni, ka zënë vendin e dytë në poezi, në konkursin letrar "Ditët e shqipes", organizuar nën patronazhin e Presidentes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës "Agim Ramadani".
- Është mbajtur testi PISA në Vushtrri, në të cilin morën pjesë 13 shkolla: GJIM. "Eqrem Çabej", SHFMU "Azem Bejta", SHFMU-"Hajruallah Shala", SHFMU "Liria", SHFM "GJ.K.Skënderbeu", SHFMU "Jusuf Gërvalla", SHFMU-Lumadh, SHFMU "Rilindja", SHMP "Bahri Haxha", SHMT. "Lutfi Musiqi", SHMT. "Lutfi Musiqi", SHMT. "Lutfi Musiqi", Viciana Med, SHMU-1, SHMU-2. Gjithsej 113 nx.

- Garat e fizikës: më 12 shkurt 2022, në Gjimnazin "Eqrem Çabej" - Vushtrri, janë mbajtur garat e Fizikanëve të rinj në nivel komune, për nx. e kl. 9,10,11 dhe 12. Drejtoria e Arsimit i ka shpërblyer nxënësit që kanë arritur rezultatet më të mira, me mirënjohje dhe mjete materiale. Vendi i parë me 150.00 €, vendi i dytë 120.00 € dhe vendi i tretë me 100 €. Në nivel republikan, nxënësja Zana Ademi, nxënëse në Gjimnazin "Eqrem Çabej" - Vushtrri, ka zënë vendin e 5 (pestë), kurse nxënësja Atdhetare Kameri, nxënëse në SHFMU "Adem Voca"

Sumë - Vushtrri, ka zënë vendin e nëntë (9). Drejtoria e Arsimit për këtë garë i ka shpërblyer të dy nxënëset me mirënjohje dhe mjete materiale në shumën 250.00 €.

- Garat e matematikës: më 19 shkurt 2022, në SHMU-2 në Vushtrri, janë mbajtur garat e OMK në nivel komune, për nx. e kl. 9,10,11 dhe 12. Drejtoria e Arsimit i ka shpërblyer nxënësit që kanë arritur rezultate më të mira, me mirënjohje dhe mjete materiale. Vendi i parë me 150.00 €, vendi i dytë 120.00 € dhe vendi i tretë me 100 €. Më 6 mars 2022, kemi marrë pjesë në garat Republikane të OMK që u mbajtën në Gjimnazin e Specializuar të Matematikës në Prishtinë. Në këtë garë kanë marrë pjesë pesë (5) nxënës nga kl.9, 10, 11 dhe 12 që janë përzgjedhur nga gara komunale e mbajtur më 19.02.2022. Për këtë garë janë shpërblyer 12 nxënës në shumën prej 1,480.00 €.

Gjithsej për garat në Fizikë dhe Matematikë, janë shpërblyer 21 nxënës në shumën 2,840.00 €.

## IV. Donacionet

- SHFMU "Jusuf Gërvalla" Dumnicë e Poshtme u rinovua komplet nga "ALBERTI" me pronar Skënder Bajramin, me vlerë 200, 000.00€.
- SHFMU "Emin Duraku" Novolan, pranoi donacion nga bashkëvendësi i tyre z. ABDULLAH KOVAÇI me 5 TV-SMART në vlerë 3000€.
- SHFMU "Rexhep Musa" Ceceli, ka pranuar nga IADK, me seli në Nedakoc, 4 projektorë, si dhe nga Kompania "Emona Center", në Vushtrri 4 kompjuterë.
- SHFMU "Mustafë Shyti" Oshlan është pajisur me 10 çanta për nxënës nga ETC.
- SHFMU "Rilindja" Maxhunaj është pajisur me një projektor nga MASHT-i për raportimin e rasteve të dhunës në SMIA.
- Të gjitha SHFMU janë pajisur me mikro bit.
- SHFMU "Migjeni" Stanoc, është pajisur nga KEC me 50 tituj librash për bibliotekën e shkollës.
- IP "Foleja" është pajisur me Smard bord për tri çerdhet, projektor për tri çerdhet, televizor për tri çerdhet, lodra për oborr (topogan, luhatëse, ulëse nga druri, kali lëvizës, shtëpizë nga materiali PCV, varëse për TV për tri çerdhet). Ky projekt është realizuar në kuadër të projektit "Sensibilizimi i mëtejmë i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Komunën e Vushtrrisë përmes mbështetjes së shtuar socio-ekonomike" dhe është realizuar përmes financimit të përbashkët nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik "PREDA PLUS" dhe Komunës së Vushtrrisë në vlerë prej 25.999.00 €.
- Më 15.3.2022, së bashku me KK-Komunal, ishim në SHFMU "Jusuf Gërvalla" për të përcjellë dorëzimin e donacioneve nga JIC-a Japoneze dhe KK i Kosovës. Donacioni përfshinte kryesisht mjete për mbrojtje dhe ndihmë në rast rreziku për komunitetin. Për vlerën e këtyre pajisjeve nuk kemi faturë, por sipas deklarimit të donatorit shuma është 10,000.00 €.
- SHFMU "Liria" Stroc, përfitoi donacion nga Forumi për Integrim Social – FIS në bashkëpunim me zyrën e Presidentes së Kosovës – donacion: ngjyra, pëlhura, brusha për ekspozitë, vlera 200.00 euro, KEC - donacion: mbjellja e 130 pemëve frutore ( 30 ari), projektor, ngjyra, pëlhura, këmbalec për piukturë, brusha, promovimi i vlerave të shkollës, kurse vlera totale 950.00 €, trajnim dhe materiale nga USAID – Vetëdijesimi lidhur me bullizmin në shkollë, vlera totale 500€, British Council donacion: pajisje për kodim vler,a 2000 €, trajnim nga Fatos Durmushi (me banim në Suedi) ekspert për ligjëratën "Shëndeti mendor në jetën e përditshme" mbajtur me nxënësit e

klasave të 8 dhe 9 –ta vlera e trajnimit 500.00€. N. Përparimi donacion: lule, vlera e tyre 200€, poetja vushtrriase Ermira Jusufi donacion: libra të ndryshëm, vlera e tyre 1500€.

- Gjimnazi pranoi donacion nga KEC 45 tituj librash, me vlerë 135 €, 20 llaptopa në vlerë 14,000.00 €, 2 PC në vlerë 1000.00€, 10 tabletë me vlerë 2000.00, SMART TV me vlerë 700.00. Aset USAID ka përfituar pajisje teknologjike të përdorura në vlerë 2539.00 dollarë.
- SHMU-1 pranoi donacion pajisje teknologjike nga GIZ me vlerë 2086.57.00€.

## V. Bashkëpunimet me organizata

- Takim më përfaqësuesit e organizatës "BOZporus" nga Holanda lidhur me renovimin e paraleles në Beçiq, të SHFMU "Azem Bejta" Duboc dhe SHFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë.
- Bashkëpunim me CARITASIN zviceran lidhur me trajnimin e edukatorëve.
- Takim me përfaqësuesit e organizatës "Up to youth" – USAID lidhur me infrastrukturë shkollore.
- Bashkëpunim për pesë (5) mësuese mbështetëse me shoqatën "Torres Des Homes".
- Bashkëpunim me organizatën gjermane "GIZ" lidhur me çështjen punësimit të të rinjve.
- Bashkëpunim me ICMLD rreth projektit MIS 2, edukimi mjedisor në arsimin parashkollor.
- Bashkëpunimi "Internacional Charity" për hapjen e dy puseve, njërin në SHFMU "Rilindja" Maxhunaj dhe tjetri në Pestovë.
- Bashkëpunim me OJQ "VORAE" rreth komunitetit pakicë.
- Bashkëpunimi OJQ "Koralet" në kuadër të UNICEF për edukatoret.
- Bashkëpunimi me IOM, lidhur me dërgimin e 8 nxënësve në Brezovicë nga SHFMU "Nazmi Zhegrova" Stanoc i Poshtëm.
- Pjesëmarrje me drejtorin e SHMP "Bahri Haxha" për shkollat e Ballkanit, lidhur me projektin #Super Schools# i organizatës RYCO.
- Bashkëpunim me Qendrën Psiko-sociale për trauma - terapi "Diakonie Kosova" znj. Albina Koliqi Musliu, ku i ofroi nxënësve të komunës trajtim falas në këtë qendër, ndërkaq në disa shkolla mbajtje e ligjëratave me mësimdhënës.
- Më datë: 14.6.2022 u mbajt ceremonia e ndarjes së çmimeve "Shkolla mike dhe pa abuzim" e cila është organizuar për të dytin vit me radhë, në kuadër të projektit "Së bashku kundër abuzimit të fëmijës", të cilin është duke e zbatuar organizata "Qendra për Arsim e Kosovës" (KEC) në bashkëpunim me organizatën "Qendra për Studime të Avancuara" (FIT) dhe DA-në Vushtrri.

## VI. Trajnimet

- SHFMU “Liria” Stroc: Trajnim për mësimdhënëset 6-9 “Mësimi i mendimit kritik dhe zgjedhës i problemeve”.
- Janë trajnuar 66 mësimdhënës për KK.
- Organizimi i trajnimit për edukatore, përmes UNICEF-it OJQ “Koralet” në Fakultetin e Edukimit në Mitrovicë.
- Trajnime për edukatore, përgatitja e programit parafillor për përkrahje dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitet nga CARITASI zvicrran.
- Më datë 18, 19 shator u mbajt trajnimi i drejtorëve në programin “Shkollat e shekullit 21”, organizuar nga British Council, lidhur me micro-trajnimin e edukatoreve të klasës përgatitore, përmes projektit “Shpresa” të Caritasit zviceran.

# VII. Garat sportive

## VII.1. Arritjet sportive jashtë vendit:

- Më datë: 15.5.2022, dy nxënës të SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri, kanë qëndruar në Normandi të Francës në sportin e ping-pongut ku Shkolla e mesme profesionale "Bahri Haxha" Vushtrri ka përfaqësuar Kosovën në konkurrencën e meshkujve. Në këto gara janë përfshirë 14 sporte, me pjesëmarrje rreth 4000 nxënës nga e gjithë bota.
- Më datë 12 qershor deri më 16 qershor 2022, u mbajtën garat në hendboll në nivel ballkanik në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Ekipi i vajzave të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri u rendit në vendin e tretë.

## VII.2. Arritjet sportive në nivel komunal dhe në nivel vendi:

| Emri i shkollës | Sporti | Gj. | Vendi që kanë fituar | Data: | Nr. nx. | Nr. mësimdhënësve të angazhuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SHMU 2 | Basketboll | M | Vendi i parë në nivel komunal<br>Pjesëmarrës në nivel republike | 22.11.2021<br>1.12.2021 | 12 | 2 |
| SHMU 1 | Basketboll | F | Vendi i parë në nivel komunal<br>Pjesëmarrës në nivel republike | 22.11.2021<br>1.12.2021 | 12 | 2 |
| "Lutfi Musiqi" | Basketboll | M | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i dytë në nivel republike | 22.11.2021<br>2.12.2021 | 12 | 2 |
| "Eqrem Çabej" | Basketboll | F | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i dytë në nivel republike | 22.11.2021<br>2.12.2021 | 12 | 2 |
| SHMU 2 | Shah | F/M | Vendi i parë në nivel komunal | 8.12.2021 | 6 | 2 |
| SHMU 2 | Ping pong | M | Vendi i parë në nivel komunal<br>Pjesëmarrës në nivel republike | 25.1.2022<br>10.2.2022 | 5 | 2 |
| SHMU 2 | Ping pong | F | Vendi i parë në nivel komunal | 25.1.2022 | 5 | 2 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| “Bahri Haxha” | Ping pong | M | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i dytë në nivel republike | 25.1.2022<br>10.2.2022 | 3 | 2 | |
| “Bahri Haxha” | Ping pong | F | Vendi i parë në nivel komunal | 25.1.2022 | 3 | 2 | |
| SHMU 2 | Hendboll | M | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i dytë në nivel republike | 9.3.2022<br>31.3.2022 | 12 | 3 | |
| “Lumni Surdulli” | Hendboll | F | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i parë në nivel republike | 9.3.2022<br>31.3.2022 | 12 | 1 | |
| “Eqrem Çabej” | Hendboll | F | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i parë në nivel republike | 9.3.2022<br>31.3.2022 | 12 | 2 | |
| SHMU 2 | Futsall | M | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i parë në nivel republike | 29.3.2022<br>29.4.2022 | 10 | 2 | |
| “Liria” | Futsall | F | Vendi i parë në nivel komunal<br>Pjesëmarrës në nivel republike | 29.3.2022<br>29.4.2022 | 10 | 1 | |
| “Eqrem Çabej” | Futsall | M | Vendi i parë në nivel komunal<br>Vendi i dytë në nivel republike | 29.3.2022<br>29.4.2022 | 10 | 2 | |
| “Eqrem Çabej” | Futsall | F | Vendi i parë në nivel komunal | 29.3.2022 | 10 | 2 | |
| “Bahri Haxha” | Volejboll | M | Vendi i parë në nivel komunal | 5.5.2022 | 12 | 2 | |
| “Eqrem Çabej” | Volejboll | F | Vendi i parë në nivel komunal | 5.5.2022 | 12 | 2 | |
| “Rexhep Musa” | Volejboll | M | Vendi i parë në nivel komunal | 20.5.2022 | 12 | 1 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| “Rilindja” | Volejboll | F | Vendi i parë në nivel komunal<br>Pjesëmarrës në nivel republike | 20.5.2022<br>26.5.2022 | 12 | 2 |

Njëherazi, 2 ekipe nga SHMU-2 dhe SHMU 1 janë pjesëmarrëse NBA Kosova (ligë e basketbollit) në kategorinë mix (femra dhe meshkuj), me nxënës të klasave të shtata (nën moshën 12 vjeç) me nga 12 lojtarë (gjithsej 24 nx. dhe 2 mësimdhënës).

## VIII. Rezultatet e testit të arritshmërisë

| Viti | 2019 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| % | 49.43 | 49.78 | 44.59 |




Vërejtje: testi i arritshmërisë nuk është mbajtur në vitin 2020 për shkak të pandemisë Covid-19.

Tri shkollat të cilat u renditën me përqindje më të lartë në testin e arritshmërisë:

SHFMU ”Emin Duraku” Novolan, 60.45%;

SHFMU- Nedakoc, 58.84%;

SHFMU “Mustafë Shyti” Oshlan, 55.50%.

## IX. Testi i maturës

**Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri:**

| Viti | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| % | 99.20% | 99.00% | 99.60% |



## SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri

| Viti | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| % | 39.53% | 48.38% | 72,87% |



**SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri**

| Viti | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| % | 40.70% | 31.00% | 65.04% |



## X. Suksesi në fund të vitit shkollor 2021/22

Klasa 1-5

| Periudha e njëjtë | Suksesi i fundvitit shkollor 2021/22, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020/21, për klasën 1-5 | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shkëlqyshëm | % | Sh.mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të panotuar | % | Të pamjaftueshëm | % | Gj. |
| 2022 | 3301 | 65.34 | 1057 | 20.92 | 525 | 10.39 | 162 | 3.21 | 2 | 0.04 | 5 | 0.10 | 5052 |
| 2021 | 3507 | 68.04 | 958 | 18.58 | 537 | 10.41 | 151 | 2.92 | 0 | 0 | 1 | 0.01 | 5154 |
| Krahasimi | | -2.70 | | 2.34 | | -0.02 | | 0.29 | | 0.04 | | 0.09 | |

Shkëlqyeshëm - kemi rënie të suksesit për 2.7%;

Shumë mirë - kemi ngritje të suksesit për 2.34%;

Mirë - kemi rënie të suksesit për 0.02 %;

Mjaftueshëm - kemi ngritje të suksesit për 0.29%;

Të pamjaftueshëm - kemi ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.09%.




Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021/22 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020/21, për klasën 1-5

| Suksesi kl.I-V | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Fundi i vitit shkollor /periudha e njëjtë | Pozitiv | % | Negativ | % |
| 2022 | 5047 | 99.90 | 5 | 0.10 |
| 2021 | 5153 | 99.98 | 1 | 0.02 |
| Krahasimi | | -0.08 | | 0.08 |

Suksesi ka rënie të kalueshmërisë për 0.08%.



Klasa 6-9

| Periudha e njëjtë | Suksesi i fundvitit shkollor 2021, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, për klasën kl. VI-IX | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shkëlqyeshëm | % | Sh. Mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të panotuar | % | Përsëritur klasën | % | GJ |
| 2022 | 1172 | 27.99 | 880 | 21.01 | 1108 | 26.46 | 1002 | 23.9 | 4 | 0.09 | 21 | 0.5 | 4187 |
| 2021 | 1200 | 28.72 | 932 | 22.31 | 1106 | 26.47 | 789 | 18.9 | 0 | | 19 | 0.45 | 4177 |
| Krahasimi | | -0.73 | | -1.3 | | -0.01 | | 5.05 | | 0.09 | | 0.05 | 10 |

Shkëlqyeshëm - kemi rënie të suksesit për 0.73 %;

Shumë mirë - kemi rënie të suksesit për 1.3%;

Mirë - kemi rënie të suksesit për 0.01 %;

Mjaftueshëm - kemi ngritje të suksesit për 5.05 %;

Përsëritin klasën - kemi ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.05%.




| Suksesi kl.VI-IX | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Fundi i vitit shkollor / periudha e njëjtë | Pozitiv | % | Negativ | % |
| 2022 | 4166 | 99.50 | 21 | 0.50 |
| 2021 | 4158 | 99.55 | 19 | 0.45 |
| Krahasimi | | -0.05 | | 0.05 |

Suksesi ka rënie të kalueshmërisë për 0.05%.


Periudha e njëjtë
2022
2021
Krahasimi
4166
4158
99.50
99.55
-0.05
21
19
0.50
0.45
0.05
Pozitiv
%
Negativ
%

| Periudha e njëjtë | Suksesi i fundvitit shkollor 2021, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, për klasën 10-12 | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shkëlqyeshëm | % | Sh. Mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të panotuar | % | Të pamjaftueshëm | % | GJ. |
| 2022 | 341 | 13.78 | 500 | 20.20 | 774 | 31.27 | 813 | 32.8 | 4 | 0.16 | 43 | 1.74 | 2475 |
| 2021 | 314 | 12.22 | 479 | 18.64 | 794 | 30.9 | 943 | 36.9 | 1 | 0.04 | 38 | 1.25 | 2569 |
| Krahasimi | | -3.1 | | -2.74 | | -3.4 | | 8.2 | | -0.1 | | 1.14 | -121 |

Shkëlqyeshëm - kemi rënie të suksesit për 3.1 %;

Shumë mirë - kemi rënie të suksesit për 2.74%;

Mirë - kemi rënie të suksesit për 3.4 %;

Mjaftueshëm - kemi ngritje të suksesit për 8.2 %;

Përsëritin klasën - kemi ngritje të pamjaftueshmërisë për 1.14%.




Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, për klasën 10-12

| Suksesi kl.X-XII | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Fundi i vitit shkollor / periudha e njëjtë | Pozitiv | % | Negativ | % |
| 2022 | 2432 | 98.26 | 43 | 1.74 |
| 2021 | 2531 | 98.52 | 38 | 1.48 |
| Krahasimi | | -0.26 | | 0.26 |




Suksesi ka rënie të kalueshmërisë për 0.05%.

## XI. Përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022/2022

Të gjitha institucionet shkollore kanë bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023, me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e procesit mësimor.

- Përgatitjet për kuadrin arsimor për fillimin e vitit shkollor 2022/2023 u bënë me kohë dhe janë plotësuar vendet e lira të punës, përveç për lëndën e gjuhës gjermane për të cilën nuk ka pasur kandidatë të mjaftueshëm, kështu që e kemi shpallur përsëri.
- Të gjitha objektet e shkollave ofrojnë kushte teknike për një fillim të mbarë.
- Janë rinovuar shkollat.
- Janë shpërndarë librat.
- Nga data 25 gusht 2022, ka filluar greva në të gjitha institucionet arsimore në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa vazhdimisht kanë punuar vetëm 2 mësimdhënëse klase në SHF "Mustafë Venhari" Vushtrri, si dhe SHFMU- Lumadh kanë filluar të punojnë vetëm 2 mësimdhënëse klase dhe 4 mësimdhënës lëndor, nga data: 19.09.2022. Mësimdhënësit e SHF "Naim Frashëri" Vushtrri, kanë qenë të gatshëm të punojnë që nga fillimi, përveç dy mësimdhënësve, për shkak të rinovimit edhe kjo shkollë nuk ka punuar;
- Numri i nxënësve në nivele për vitin shkollor 2022/23:

Niveli: 1018 nxënës;

Niveli 1: (1-5) 5243 nxënës;

Niveli 2: (6-9) 4062 nxënës;

Niveli 3: ( 10-12) 2828 nxënës;

Gjithsej 13151 nxënës.

Republika e Kosovës | Komuna Vushtrri

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**

| | |
|---|---|
| **DATË:** | 6.10.2022 |
| **REFERENCË:** | Nr. 03/102/2022 |
| **PËR:** | **KPF-në dhe KK-në, Vushtrri** |
| **CC:** | Sekretaria e Kuvendit |
| **NGA:** | **Medina Bunjaku**<br>Drejtoreshë e DKRS-së |
| **TEMA:** | Informatë nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve, kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun |

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022, 01 nr. 22/22, të datës 31.1.2022, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport paraqet këtë:

# INFORMATË NËNTËMUJORE LIDHUR ME ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E AKTIVITETEVE, KULTURORE, RINORE DHE SPORTIVE, DUKE PËRFSHIRË TEATRIN, BIBLIOTEKËN DHE MUZEUN

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara vepron me sektorët e saj, andaj edhe informata është e përpiluar sipas punës së sektorëve që veprojnë, duke paraqitur në informatë aktivitetet më të rëndësishme që janë organizuar nga DKRS, përkatësisht sektorët e saj, si në vijim:

## I. QENDRA E KULTURËS "HASAN PRISHTINA"

Qendra e kulturës "Hasan Prishtina" funksionon në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe në kuadër të objektit të Qendrës së kulturës funksionojnë këto institucione: Zyra e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Biblioteka "Naim Frashëri", Arkivi i qytetit, Teatri i qytetit "Adem Mikullovci", Ansambli i këngëve dhe valleve "Hasan Prishtina". Gjithashtu në objekt kemi

edhe Galerinë e arteve dhe atelienë, por që nuk kanë staf të angazhuar zyrtar nga komuna, si dhe zyra e rekrutimit e cila funksionon në kuadër të Zyrës së personelit.
Në kuadër të stafit të Qendrës për kulturë "Hasan Prishtina", duke mos përfshirë stafin e bibliotekës, arkivit dhe teatrit, kemi këtë përbërje: drejtori i Qendrës për kulturë, udhëheqësi i AKV-së, koreografi i AKV-së, dy instrumentistë dhe dy punëtorë teknikë.

Gjatë këtij nëntëmujori, Qendra e kulturës ka organizuar apo ka mbështetur në organizim të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu ka ndihmuar në organizmin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë.

Ne në vazhdimësi kemi mbështetur, por edhe kemi marrë pjesë në organizimin e shumë takimeve letrare, si promovime të librave të ndryshëm në territorin e komunës sonë, por edhe jashtë, kryesisht të autorëve vushtrrias. Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre, në Galerinë e arteve në Qendrën e kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e qytetit "Adem Mikullovci".

Një punëtor i QK "Hasan Prishtina" mban në vazhdimësi të hapur dhe përkujdeset për Kalanë e qytetit.

Punëtorët e QK "Hasan Prishtina" çdoherë janë të gatshëm të kryejnë detyrat e marra nga drejtori i QK apo edhe nga drejtoresha e DKRS-së, qoftë brenda orarit të punës apo edhe jashtë orarit. Gjithashtu edhe drejtori i Qendrës për kulturë çdoherë është i gatshëm të kryejë detyrat, të cilat i merr nga DKRS-ja. Në aktivitetet e zakonshme që i organizojmë si drejtori, por edhe aktivitet tjera të organizuara qoftë nga Kryetari i komunës apo Drejtoria e Arsimit, ose edhe sektorët tjerë të DKRS-së ne kemi qenë të angazhuar në mbarëvajtjen e atyre organizimeve qoftë në mbështetje teknike me mjete të zërimit apo edhe mjete tjera teknike. Drejtori i Qendrës së kulturës, përveç detyrës së tij zyrtare, nga fillimi i muajit shkurt është angazhuar me vullnetin e tij edhe në kryerjen e detyrës të zyrtarit të informimit, duke marrë në konsideratë se Komuna e Vushtrrisë ka mungesë të zyrtarëve në këtë drejtim.

Ndër aktivitetet kulturore që janë organizuar nën patronazhin e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, përkatësisht nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në të cilat Qendra e kulturës ka organizuar aktivitetin apo ka marrë pjesë në aktivitet veçojmë:

- Organizimi i ceremonisë për shpalljen e sportistëve të vitit 2021, më 28 janar 2022;
- Promovimi i librit "Viciana – Vushtrria I", nga autori Izet Miftari, 15 shkurt 2022;
- Hapja e ekspozitës me punime prej letre ORIGAMI, nga Hadije Zuçaku, 15 shkurt 2022;
- Promovimi i librit "Syzheu i jetës", nga Arxhela Krasniqi, 25 shkurt 2022;
- Akademi solemne për nder të Ditës të Pavarësisë të Republikës së Kosovës, 17 shkurt 2022;
- Aktiviteti "Mësuesi i lirisë", në kuadër të Epopesë së UÇK-së, 7 mars 2022;
- Aktiviteti "Këpucët e kuqe", kushtuar grave që kanë humbur jetën si pasojë e dhunës, 8.3.2022;
- Akademi përkujtimore për prof. Fahri Buçincën, më 18 mars 2022;
- Ekspozitë me fotografi "Fshatrat e Vushtrrisë", të autorit Berat Mernica, 25 mars 2022;

- Përurimi i librave "Njeriu i lartësive", të autorit Gëzim Saraçi dhe "Dhe unë jam njeri", të autorit Lulëzim Krasniqi – Arbanasi, 1 prill 2022, i cili ndonëse është mbajtur në Prishtinë, është organizuar nga Komuna e Vushtrrisë;
- Akademi përkujtimore dhe zbulimi i lapidarit të dëshmorit Blerim Agim Saraçit, 2 prill 2022;
- Shfaqja "Akraballëkët", në regji të Fazli Muharremit, 9 prill 2022;
- Akademi përkujtimore dhe zbulimi i lapidarit të dëshmorit Avni Hajdin Klinakut, 18 prill 2022;
- Akademi përkujtimore "Studimja '99", më 2 maj 2022;
- Homazhe për nder të përkujtimit të Masakrës së 22 Majit në Vushtrri, më 22 maj 2022;
- Koncert "Kultura na bashkon", në bashkëpunim me AKV "Mirdita", nga Mirdita e Shqipërisë;
- Fillimi i Kursit të artit figurativ, i cili po zhvillohet në atelienë e Qendrës së kulturës, nga data 30 maj 2022 dhe po vazhdon akoma;
- Akademi përkujtimore për Masakrën mbi familjen Gërxhaliu, 31 maj 2022;
- Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të "Ditës së fëmijëve", 1 Qershori 2022;
- Akademi solemne për nder të "Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë", 17 qershor 2022;
- Koncert me grupin muzikor "TNT", në Sheshin "Adem Jashari", më 17 qershor 2022;
- Përurimi i librit "Mos ma vjedh lirinë", të autorit Burim Gjaka, 16 qershor 2022;
- Ekspozitë "Into the ocean" të artistes vushtrriase Fjolla Ferati, në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës";
- Koncerti "Ti je pjesë e atdheut", ku kanë performuar solistë të shumtë nga AKV "Hasan Prishtina", si dhe mysafiri special Ramadan Krasniqi – Dani, në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës";
- Përurimi i librit "Unë, biri i Oshlanit heroik", i autorit Islam Islami, i cili është një bashkatdhetar që jeton në mërgim, në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës";
- Tryezë për promovimin e turizmit malor, agroturizmit dhe turizmit urban në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës";
- Aktivitete kulturore me bashkatdhetarë "Stroci feston", që është mbajtur në Stroc, më 31.7.2022, ku kemi qenë me mjete të zërimit dhe me valltarë të AKV "Hasan Prishtina";
- Është përmbyllur pjesa e trajnimit në Kursin e pikturës, i cili është mbajtur në Qendrën e kulturës nga prof. Samedin Latifi dhe ku pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata për ndjekjen e kursit;
- Përurimi i librit "Dialog me gjyshin", të autorit Ibrahim Kuçi;
- Promovimi i librit "Halit Çuka – simbol i qëndresës shqiptare" të autorit Qazim Azemit;
- Hapja e ekspozitës të piktorëve vushtrrias Merxhan Sholla, Shukri Përçuku dhe Safet Rexha, pjesa e dytë e Manifestimit "Ditët e diasporës";
- Orë letrare me mërgimtarët dhe për mërgimtarët në Kalanë e qytetit, pjesa e dytë e Manifestimit "Ditët e diasporës".
- Mbështetja e të rinjve në organizimin e koncertit "Young Festival";
- Organizimi i 1 shtatorit – "Ditës të Dëshmorëve të Kombit", të Komunës së Vushtrrisë;
- Organizimi i akademisë falënderuese në bashkëpunim me Shoqatën e të burgosurve politikë "Lëvizja";
- Përurimi i librit "Kam një poezi për ty", të autores Merisa Pushkolli, e cila është nxënëse e klasës së gjashtë;
- Koncert solistik i sopranos vushtrriase Edina Pllana;
- Punëtori e organizuar nga Helvetas, në lidhje me krijimin e data-bazës që lehtëson mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Ndër aktivitetet e veçanta që vlen të raportohet edhe organizimi i Festivalit "Takimet e Poeteshave Shqiptare", edicioni i 40-të, për të cilin kanë filluar parapërgatitjet për organizimin, mirëpo nga këshilli organizues është menduar se kjo ngjarje është mirë të organizohet në kuadër të festave të nëntorit, bashkë me ngjarje tjera të rëndësishme që planifikohen në kuadër të DKRS-së.

Drejtori i QK "Hasan Prishtina" ka qenë edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim të botimeve dhe publikimeve, por edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave të tjera për subvencionim, bazuar në Rregulloren e MF për ndarjen e subvencioneve, si dhe në komisione tjera për vlerësim të projekteve të DKRS-së.

Drejtori i Qendrës së kulturës, në cilësinë e zyrtarit për informim ka marrë pjesë në katër trajnime, që kryesisht kishin të bënin me protokollin.

Drejtori i Qendrës së kulturës është caktuar edhe kryesues i Komisionit për ndarjen e subvencioneve për fushën e kulturës, në bazë të thirrjes publike, nga e cila janë shpallur 7 përfitues.

## II. MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

- Më 9.6.2022, muzeu ka shënuar aktivitetin e përvjetorit të 17-të, të themelimit të Muzeut të Vushtrrisë. Prandaj me përkrahjen e Kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi dhe drejtores të DKRS-së znj. Medina Bunjaku, më 9.6.2022 u organizua aktiviteti me nxënës, i quajtur: "Eksponatet e muzeut përmes syve të fëmijëve". Aktiviteti u zhvillua nga muzeu dhe nxënësit e shkollës fillore "Naim Frashëri", duke vizatuar dhe interpretuar pasuritë muzeale.

- Përgatitja dhe përcjellja e propozimeve dhe ideve në kuadër të investimeve kapitale për funksionalizimin e veprimtarisë të muzeut për vitin 2023.
- Kemi vazhduar punën në hulumtimin e biografive të të burgosurve politikë gjatë periudhës 1944-1950 në Vushtrri dhe rrethinë, duke mbledhur dhe regjistruar në muze edhe plotë 14 histori-biografi të të burgosurve politikë.

Gjithashtu, janë vizituar dhe intervistuar familjet;

  - Familja Maxhuni dhe Xoni për gjyshërit dhe prindërit e burgosur dhe të keqtrajtuar gjatë asaj kohe.
  - Familja Plakolli për familjarin e tyre Zija Shaban Plakollin, i cili ishte burgosur e keqtrajtuar gjatë asaj kohe (1944-1950).
  - Familja e Hazbi Maxhunit, me të cilët u zhvillua intervistë për familjarin e tyre Shefqet Maxhunin, i burgosur dhe i vrarë gjatë viteve 1944-1950.
  - Intervistë me z.Ragip Abit Hyseni, për biografinë e vëllait të tij, dëshmorit Ruzhdi Hysenit të rënë në vitin 1981.

**Punët hulumtuese dhe identifikimet**

- Në kuadër të punëve hulumtuese, është hulumtuar edhe tradita e pajës (çeizit) në Komunën e Vushtrrisë, tradita e artizanatit - berberit, të ndjerit "usta Muratit" për punën dhe veprimtarinë tij ndër vite në Komunën e Vushtrrisë, si dhe historiku i monumentit "Arkivi Historik".
- Gjatë punëve hulumtuese në terren u identifikuan:
  - Në familjen Jetullahu u identifikuan dy eksponate etnologjike, gjegjësisht "dy ibrikë mesingu", për të cilët, familja në fjalë premtoi se do t'i dhurojë në muze.
  - Në familjen Mehmeti u identifikua një koritë guri rreth 100 vite e vjetër. Eksponati në fjalë është me rëndësi të veçantë për muzeun, si dhe për trashëgiminë kulturore në përgjithësi. Pas bisedës me familjen Mehmeti, ata pranuan që eksponati t'i bashkohet pasurisë muzeale.
  - Në fshatin Dobërllukë, tek familja Merovci, janë identifikuar disa eksponate etnologjike me shumë rëndësi për muzeun. Familja në fjalë është deklaruar se një pjesë të eksponateve mund t'i dhurojë në muze, por pjesa t'i kompenzohen me mjete materiale (para).
  - Në familjen Bunjaku në Vushtrri, u identifikuan dhjetëra eksponate dhe fotografi të vjetra të qytetit të vjetër të Vushtrrisë! Familja Bunjaku premtuan se fotografitë do t'i sjellin në muze, të cilat më pastaj do të inventarizohen në koleksionin e fotografive të vjetra të muzeut, ndërsa lidhur me eksponatet ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje!
  - Gjatë vizitës në terren, tek hekurishtja Tiriqi, janë identifikuar dhjetëra eksponate nga bakri e mesingu. Udhëheqësi i kësaj hekurishteje z. Haris Tiriqi, i ka ofruar muzeut shitjen e eksponateve të mbledhura ndër vite nga gjyshi dhe babai i tij.

- Gjatë pjesës së parë të vitit 2022 muzeu u pasurua edhe me disa eksponate nga fusha e etnologjisë, folklorit dhe teknologjisë të hulumtuara në Vushtrri dhe rrethinë.
  - Nga etnologjia:
    - 6 shilte – jastëk të punuar në vek;
    - 2 jastëkë shpine, po ashtu të punuar në vek;
    - 2 lëkura "posteqija" të deleve, pjesë të pandashme të odave;
    - Shoshë e vjetër rreth 60 vite;
    - Hekur metali me prush, i vjetër rreth 70 vjet;
    - Këmishë e pëlhurës e punuar në vek, e vjetër mbi 60 vjet;
    - Një palë të veshjes të komunitetit rom-ashkali;
    - Një "zavijaq" (pshtjellak) të Krahinës së Artakollit;
    - Një shpuzore apo taketuke duhani, e cila ishte gjetur në një tren të vjetër nga Shefki Vërbovci, e po ashtu është dhuruar nga i njëjti;
    - Një komplet gota qelqi të shekullit të kaluar, mbi 50 vjet të vjetra të dhuruara nga Erxhan Maloku;
    - Një djep nga materiali i drurit, i punuar me dorë dhe i zbukuruar me motife gjeometrike e florale, i dhuruar nga Ismet Hyseni;
    - Violinë e punuar rreth viteve të 60-ta;
    - Fun buke, eksponat etnologjik, i cili shërbente për ta gatuar bukën;
    - Shamia të punuara me dorë nga nënat tona.

- Nga teknologjia:
    - ➢ Tre mikrofonë të vjetër të viteve të 70-ta;
    - ➢ Një shirit filmi 16 mm;
    - ➢ Dy traka të filmit 16 mm me shirit.

- Muzeu- sektori i fototekës u pasurua me 34 fotografi dhe 2 video, siç janë:
    - ➢ Tre (3) fotografi të vjetra të viteve të 50-ta, të realizuara nga fotografë të vjetër të Vushtrrisë, Nazmi Ispahiu dhe Nesim Ispahiu;
    - ➢ Katër (4) fotografi të vjetra familjare të qytetarëve të Vushtrrisë, kryesisht të pjesës së parë të shek.XX;
    - ➢ Trembëdhjetë (13) fotografi nga tradita e rregullimit të nuseve. Traditë kjo e quajtur "zineti dhe teleisja", karakteristikë e Komunës së Vushtrrisë dhe traditës martesore në Vushtrri;
    - ➢ Tri (3) fotografi të punëtorëve të "Fabrikës së Poletit";
    - ➢ Njëmbëdhjetë (11) fotografi të shtëpive të djegura gjatë >Luftës së Fundit 1998-1999 në Vushtrri<. Fotografitë janë gjetur në Arkivin Historik të Qyetit të Vushtrrisë.

Muzeu gjithashtu u pasurua me dy (2) video të realizuara gjatë vitit 1999 nga Ferki Morina. Në video-incizime dokumentohen prona e shtëpi të djegura gjatë >Luftës së Fundit< nga forcat serbe të fshatrave Mihaliq dhe Shtruerë të Komunës së Vushtrrisë.

- Biblioteka e muzeut ka gjithsej 416 libra, kryesisht shkencorë. Prandaj është punuar në sistemimin e fondit të botimeve shkencore, në hapësirën dedikuar bibliotekës shkencore të muzeut.

Në kuadër të bibliotekës është punuar me studentë dhe lexues, duke ju ofruar shënime dhe literaturë shkencore në realizimin e detyrave dhe punimeve shkencore.

- Në muze u invetariuzuan gjithsej 74 eksponate nga kultura materiale:
    - ➢ 53 nga sektori i etnologjisë;
    - ➢ 16 nga sektori i teknologjisë;
    - ➢ 5 nga sektori i folklorit;
    - ➢ Në fillim të vitit 2022, stafi i muzeut ka organizuar ekspozitën "Teknologjia e vjetër" brenda lokalitetit të kalasë së vjetër, duke prezantuar pajisje të vjetra të filmit, pajisje të vjetra shkrimi, radio e magnetofon të ndryshëm, shirita të filmit, projektorë, etj., e cila do të qëndrojë e hapur deri në fund të vitit 2022;
    - ➢ Vizitë në SHFMU – "Mustafë Shyti" në fshatin Oshlan për t'ju ofruar mbështetje financiare dhe profesionale, duke projektuar dy vitrina për muzeun e shkollës në fjalë.
    - ➢ Për nder të ditës së "7 Marsit – Ditës së Mësuesit", stafi i muzeut në bashkëpunim me znj. Emine Tahirin përgatitën "odën tradicionale" në kuadër të aktivitetit "Sofra vushtrriase", organizuar në kuadër të DKRS-së;
    - ➢ Stafi i muzeut rëndësi të veçantë i ka kushtuar nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, të cilat kanë realizuar vizita edukative e mësimore në Muzeun e Vushtrrisë - në monumentin "Mahmut agë Gjinolli". Gjatë vizitave, nxënësit u informuan për muzeun, historinë e tij dhe për pasuritë që ka muzeu;

- Muzeu priti nxënës dhe mësimdhënës nga SHFMU-të edhe të qyteteve tjera të Kosovës, të cilët u shoqëruan nga stafi i muzeut, duke vizituar »muzeun, kalanë e vjetër të qytetit, hamamin (banjon publike), urën e vjetër të gurit dhe monumente të tjera në rrethinat e qytetit«.
- Me kërkesën e Kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi dhe drejtoreshës të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Medina Bunjaku, më 2 prill u shënua "Dita Botërore e Autizmit", duke zhvilluar aktivitete solidarizimi me fëmijët autikë. Datë kjo e caktuar nga OKB-ja për rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës;
- Gjatë muajve të diasporës, muzeu u vizitua vazhdimisht nga mërgimtarët, të cilët mësuan për historinë e objektit të muzeut, monumentit "Shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit", si dhe u informuan për pasuritë e Muzeut të Vushtrrisë;
- Në kuadër të manifestimit "Ditët e Diasporës" organizuar nga Komuna e Vushtrrisë-DKRS-ja, Muzeu i Vushtrrisë improvizoi sofrën tradicionale me motive kombëtare. Në kuadër të aktivitetit u interpretua edhe muzika burimore folklorike nga Ansambli "Hasan Prishtina" dhe performues të tjerë nga vendi e diaspora;

## III. SEKTORI PËR RINI

Përgatitja e planit të punës për Sektorin e rinisë për vitin 2022.
Së bashku me Qendrën rinore, bordin e KVRL-së dhe grupet joformale, u diskutua dhe u planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2022, dhe po ashtu u bë edhe ristrukturimi i këtij këshilli.
Takime pune dhe informuese me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore. Gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi, janë hartuar projekt-propozime dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.
Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE, ku janë plotësuar disa pyetësor që janë dërguar nga ta, kurse OSCE edhe njëherë ka shpreh gatishmëri që të bashkëpunojë në aktivitete të ndryshme në fushat të cilat mund të na ndihmojë OSCE-ja.
Qendra rinore "Hareja" ka mbajtur trajnime për rrobaqepësi dhe modë, për gra dhe vajza të grupmoshave të ndryshme. Në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrëseve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve. Ky projekt është mbështetur nga IOM dhe është asistuar nga Sektori i rinisë.
Janë njoftuar të gjitha OJQ-të rinore, KVRL-ja, Qendra rinore si dhe grupet joformale të të rinjve për thirrjen publike për mbështetje financiare nga komuna. Gjithashtu janë njoftuar edhe për thirrjet nga MKRS-ja, si dhe do t'u ofrohet mbështetje aq sa do të jetë e mundshme në kapacitetet tona.

Takime me kryetaren e KVRL-së. Në këto takime u planifikua për projektet që parasheh të organizojë KVRL, po ashtu u diskutua për sfidat dhe problemet që ka KVRL e një ndër to edhe hapja e llogarisë nga KVRL si dhe çështje të ndryshme rreth KVRL-së.

Organizata Rinore "Access" në bashkëpunim me Sektorin e rinisë dhe Departamentin e rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në Komunën e Vushtrrisë, (është hartuar projekt-propozimi dhe do të dërgohet për financim).
Takime pune me përfaqësuesit e The Power of Mind dhe KVRL-së, ata kanë hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal. Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhshme.

Takim me përfaqësuesin e OJQ "Lëvizja Koha" me të cilin u diskutua për projektet që parasheh të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje në fonde të donatorëve të ndryshëm.
Është në realizim e sipër projekti "Komuna për të rinjtë". Ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore, si dhe organizatës facilituese CDF. Ky projekt do të ketë një impakt të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shuma totale për mbështetjen e të rinjve në total arrin vlerën 250.000.00 dollarë amerikan.
KVRL në bashkëpunim me organizatën "Domain for Kosovo" kanë mbajtur sesion informues për të rinjtë në shkollat e mesme. Ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjve për themelimin dhe punën e KVRL-së, si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.
Trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra rinore "Hareja" e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar.

Punë dhe takime të ndryshme me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve rinore.

## III. SEKTORI I SPORTIT

| Aktiviteti | Gjithsej | Me pagesë | Pa pagesë |
|---|---|---|---|
| Stërvitje | 2579 | | |
| Ndeshje | 279 | | |
| Rekreacion | 144 | | |

| Num-ër Rend-or | Emri i shfrytëzuesit të palestrës | Stërvitje | | Ndeshje | | Rekreacion | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Me pagesë | Pa pagesë | Me pagesë | Pa pagesë | Me pagesë | Pa pagesë |
| 1 | Kl. i boksit "KALAJA" | | 108 | | | | |
| 2 | Kl. i boksit "VUSHTRRIA" | | 108 | | | | |
| 3 | Kl. i basketbollit "VU BASKET" | | 355 | | 72 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Kl. i basketbollit "VUSHTRRIA" - F | | 144 | | 12 | | |
| 5 | Kl. i basketbollit "VUSHTRRIA" - M | | 144 | | 15 | | |
| 6 | Kl. i gjimnastikës "VUSHTRRIA" | | 216 | | | | |
| 7 | Kl. i hendbollit "VUSHTRRIA" - F | | 144 | | 36 | | |
| 8 | Kl. i hendbollit "VUSHTRRIA" - M | | 144 | | 36 | | |
| 9 | Kl. i hendbollit "SAMADREXHA" - F | | | | | | |
| 10 | Kl. i hendbollit "SAMADREXHA" - M | | | | | | |
| 11 | Kl. i volejbollit "VUSHTRRIA" - F | | 180 | | 36 | | |
| 13 | Kl. i volejbollit "AS VUSHTRRIA" - M | | 144 | | 36 | | |
| 14 | Kl. i volejbollit "AS VUSHTRRIA" - F | | 144 | | 36 | | |
| 15 | Kl. i pingpongut "H.PRISHTINA" | | 216 | | | | |
| 16 | Kl. i pingpongut "VUSHTRRIA" | | 216 | | | | |
| 17 | Kl. i xhudos "VICIANUM" | | 108 | | | | |
| 19 | Kl. i mundjes "KOSOVA" | | 64 | | | | |
| 22 | Gëzim Sokoli | | | | | | |
| 25 | Shoqata e të shurdhërve | | 36 | | | | |
| 27 | Agron Neziri | | | | | | |
| 28 | Besart Muja | | | | | | |
| 29 | Kl. i basketbollit "GJIMNAZISTI" | | 36 | | | | |
| 30 | KXH Studenti | | 72 | | | | |
| 31 | | | | | | | |
| | TOTALI | | 2579 | | 279 | | 144 |

## IV. BIBLIOTEKA KOMUNALE "NAIM FRASHËRI"

Biblioteka komunale "Naim Frashëri" në Vushtrri, detyrat dhe obligimet vjetore i kryen në bazë të planit vjetor, të hartuar në çdo fillimviti.

*Të dhënat statistikore për periudhën 1 janar – 30 shtator 2022:*

1. Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim 3165 libra;
2. Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim 2597 libra;
3. Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 1352 lexues;
4. Janë përpunuar 485 libra;
5. Lexues të regjistruar në sektorin për të rritur 52 vetë;
   Lexues të regjistruar në sektorin për fëmijë ishin 74.

Në dy sektorët janë të regjistruar **126** lexues, derisa janë dhënë për lexim **5762** libra.
Në sektorin për fëmijë, libri më i kërkuar për lexim ishte: **"Lulet e Verës"**, i autorit Naim Frashëri.
Në sektorin për të rritur, librat më të kërkuar për lexim ishin:

1. **"Historia e Skënderbeut"** e Marin Barleti.
2. **"Xha Gorio"**, i autorit Onore De Balzak.

Gjatë periudhës janar – 30 shtator 2022, në bibliotekë kanë hyrë 527 libra të dhuruara.

Stafi i bibliotekës ka qenë në vazhdimësi i angazhuar në organizmin e manifestimeve kulturo-artistike, në rastin e shënimeve të ndryshme kombëtare shtetërore. Në veçanti kanë qenë të angazhuar në mbajtjen e akademive përkujtimore, pastaj në organizmin e Konferencës shkencore, në kuadër të manifestimit "Ditët e Hasan Prishtinës", si dhe në datat e rëndësishme shtetërore. Nga ana tjetër udhëheqësi i Sektorit të bibliotekës, dr.sc. Izet Miftari, ka dhënë dhjetëra intervista televizive të karakterit shkencor, duke dhënë opinionet historike për qytetin e Vushtrrisë dhe ngjarje të tjera të karakterit kombëtar e ndërkombëtar.

Stafi i bibliotekës ka qenë i angazhuar edhe në organizimin e "Ditëve të Diasporës 2022".

Gjatë periudhës janar – 30 shtator 2022, nga Shërbimi Sprovues i Kosovës – Zyra Rajonale në Mitrovicë, janë dërguar tre të mitur delikuentë, për të kryer punë të dobishme shoqërore, të dënuar nga gjykata.

Gjatë këtij gjashtëmujori, bibliotekën e kanë vizituar qindra nxënës të shkollave të fshatrave dhe të qytetit të Vushtrrisë.

Gjatë muajve korrik-gusht 2022, në baza vullnetare, Adlie Kajtazi dhe Lumnije Sylejmani, kanë bërë sistemim e librave në rafte në dy sektorët e bibliotekës, në bazë të rregullit bibliotekar.

## V. TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Teatri i qytetit më 30 dhjetor 2021 ka shfaqur dramën "Emigrantët" autor Mrozhek, në interpretim të dy aktorëve Ekrem Smajli dhe Besart Bunjaku, e cila është reprizuar më 7 janar 2022 dhe është pritur jashtëzakonisht mirë nga publiku. Më 13 janar 2022 në teatrin e Vushtrrisë u shfaq komedia "Mat" në regji të Ben Apollonit, në interpretim të Brahim Bashës dhe Blerina Veselit, kurse autor ishte Ag Apolloni.
Më 10 shkurt kemi filluar përgatitjet e para me aktorë të komedisë "Akraballakët" autor Kristo Floqi, në regji të Fazli Muharremit. Më 9 prill u dha premiera e kësaj komedie ku aktruan: Besart Bunjaku, Butrint Muharremi, Tuana Grabovci, Drita Dibrani, Haki Haliti, Tuana Fetiqi dhe Alban

Xhema. Më 16 prill u reprizua kjo komedi dhe interesimi ishte shumë i mirë dhe pas dy jave kjo komedi u shfaq për nxënësit e dy shkollave SHMU-1 dhe nxënësve të shkollës të Akrashticës.
Më 16 qershor u organizua promovimi i librit "Mos ma vrit lirinë" ku teatri e morri organizimin e këtij promovimi, në të cilin interpretuan edhe tre aktorët e qytetit.
Sikur në organizimin e promovimit të librit "Të prita tek Ura e Gurit", teatri ishte në organizim dhe interpretim.
Teatri apo përgjegjësi i teatrit ishte anëtar i këshillit organizativ për nder të 17 shkurtit,17 qershorit dhe Ditëve të diasporës.
Më 2 dhe 3 gusht, në Teatrin e qytetit u mbajt premiera e filmit "Bomba".
Më 13 gusht takim me aktorët e rinj, për fillimin e shfaqjes për fëmijë "Ariu dhe pulëbardha" dhe në tetor pritet të fillojë përgatitja e kësaj shfaqjeje. Më 20 gusht, takim me aktorët e Teatrit të qytetit si: Qamil Sahiti, Blerina Veseli, Ekrem Smajli, Besart Bunjaku, Albana Gashi, Butrint Muharremi, si dhe Deniz Verbovci (jemi në pritje që të fillojmë në prova, në momentin që mjetet iu ndahen aktorëve).

## VI. ARKIVI HISTORIK I QYTETIT-VUSHTRRI

Arkivi historik është institucion i cili pranon, evidencon, rregullon dhe publikon lëndën arkivore, mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale, si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat civilë-juridik.

Arkivi kryen veprimtarinë konform ligjit dhe akteve të përgjithshme juridike. Ky institucion punët i kryen nëpërmjet këtyre shërbimeve:

- **Shërbimi për mbrojtjen e lëndës arkivore brenda dhe jashtë arkivit;**
- **Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale;**
- **Evidentimi, rregullimi dhe klasifikimi i dokumenteve arkivore brenda arkivit;**
- **Aktivitete tjera;**
- **Punët e depos, mirëmbajtja, renditja, si dhe mbikëqyrja e dokumentacionit;**
- **Punët e udhëheqjes në arkiv;**
- **Aftësimi profesional i punëtorëve.**

Në periudhën janar- shtator 2022 kemi bashkëpunuar me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, për hartimin e ligjit të ri për arkivat.
Me kërkesë të agjencisë kemi dërguar në mënyrë elektronike rekomandimet tona në lidhje me Projektligjin nr.08/L-111 për Arkivat Shtetërore, më datë: 27.4.2022.
Kemi pasur bashkëpunim profesional edhe me Arkivin Ndërkomunal të Mitrovicës në lidhje me regjistraturat jashtë arkivit.
Në këtë periudhë kohore kemi pranuar material të ndryshëm nga Drejtoria e Kadastrit. Materiali i dorëzuar është jashtë funksionit të resorit, i cili iu ka dorëzuar arkivit komunal.
Kemi bërë vetëm ndarjen dhe klasifikimin e lëndës në sektore të caktuara, materiali pjesërisht është i vendosur në rafte arkivore.

Mungesa e përfundimit të kontratës për blerjen e rafteve të sistemit modular, ka vështirësuar punën e sistemimit të lëndës arkivore.
Si njësi arkivore dhe si staf zyrtar, kemi bashkëpunuar me DKRS dhe fushat tjera të Kuvendit Komunal Vushtrri.
Arkivi historik i qytetit menaxhohet nga udhëheqësi dhe stafi i arkivit në bashkëpunim me DKRS-Vushtrri.
Në arkivin e qytetit janë dy vende të lira si ndihmësarkivist, kështu që edhe kjo dukuri e pengon punën ekipore e cila duhet të zhvillohet në arkiv.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA VUSHTRRI

| | |
|---|---|
| DATË/A | 17 tetor 2022 |
| REFERNCË/A | **03/ 103 /22** |
| PËR/ZA/TO | **Fatmire Cecelia, anëtare e Kuvendit të Komunës** |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | Sekretarisë së Kuvendit |
| NGA/OD/FROM: | **Medina Bunjaku**<br>**Drejtoreshë e DKRS-së** |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Informatë në lidhje me të dhënat e OJQ-ve që kanë përfituar subvencione nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport |

Bazuar në kërkesën tuaj, të parashtruar në mbledhjen e fundit të Komitetit për Politikë dhe Financa në lidhje me listën e përfituesve të subvencioneve në bazë të thirrjes publike për vitin 2022, ju paraqesim të dhënat e të gjithë përfituesve në bazë të thirrjeve publike të shpallura nga DKRS, Vushtrri.

**OJQ-të QË KANË PËRFITUAR NGA SUBVENCIONIMI NË FUSHËN E RINISË**

**Emrat e projekteve dhe menaxhereve**

1.1 OJQ " Hareja " Menaxheri i projektit Bajrush Kosumi, emri i projektit "**Trajnim per Ndërmarrësi dhe kodim"**

2.2 OJQ " Lëvizja Koha " Menaxheri i projektit Gëzim Hama, emri i projektit " **Panairi i shkencës dhe kulturës 2022**

2.3 OJQ " Së Bashku per Zhvillim Demokratik" menaxher i projektit Arsim Tahiri, emri i projektit "**Te rinjtë dhe te drejtat e tyre ne vendimmarrje ne nivel lokal"**

2.4 OJQ " Strategjia Rinore" menaxher i projektit Berat Mulaku, emri i projektit "**Trajnim për shkathtësitë jetësore per të rinjtë"**

2.5 OJQ " Organizata per Demokraci dhe Aktivizem" menaxher i projektit Rinor Beqiri, emri i projektit " **Rrjetizimi dhe bashkëpunimi i te rinjve te rajonit te komunës se Vushtrrisë për zhvillim te qëndrueshëm"**

2.6 OJQ " Viciana vizion" menaxhere e projektit Liridona Rama, emri i projektit **"Yong festival"**

2.7 OJQ " Rinia aktive e Vushtrrisë "menaxhere e projektit Drita Dibrani, emri i projektit " **Youth active"**

2.8 OJQ " Qendra për rini të avancuar" menaxhere e projektit Arbenita Brahimi, emri i projektit "**Promovimi i punës vullnetare te rinise per qytetari aktive"**

2.9 OJQ " Koha në duart tona" menaxher i projektit Eroll Venhari, emri i projektit **"Integrimi social i te rinjve"**

**OJQ-të QË KANË PËRFITUAR NGA SUBVENCIONIMI NË FUSHËN E KULTURËS**

**1. Shoqata e të shurdhërve në Vushtrri**
*Menaxher i projektit:*
*Besnik Parduzi,*
*Përfaqësues i autorizuar:*
*Besim Rrahmani,*

---

**2. Pasioni Rinor**
*Menaxher i projektit dhe Përfaqësues i autorizuar:*
*Rinor Ternava,*

---

**3. Forumi për Zhvillim dhe Demokraci - FODEM**
*Menaxher i projektit dhe Përfaqësues i autorizuar:*
*Arianit Mehmeti ,*

---

**4. Organizata Komunale e pensionistëve dhe Invalidëve të Punës-Vushtrri**
*Menaxher i projektit dhe Përfaqësues i autorizuar:*
*Bedri Shala ,*

---

**5. Art Natyra 20**
*Menaxher i projektit:*
*Besart Bunjaku,*
*Përfaqësues i autorizuar:*
*Artmir Muharremi,*

---

**6. Creative Center**
*Menaxher i projektit dhe Përfaqësues i autorizuar:*
*Albiona Bejtullahu ,*

---

**7. Shoqata Drita Jonë – Vushtrri**
*Menaxher i projektit dhe Përfaqësues i autorizuar:*
*Sevdije Voca ,*

---

## OJQ-të QË KANË PËRFITUAR NGA SUBVENCIONIMI NË FUSHËN E SPORTIT

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 06.05.2022 | 03-104/02-0022877/22 | K.HENDBOLLIT-VUSHTRRIA-F | Agim Krasniqi menaxher dhe I auorizuar |
| 2 | 10.05.2022 | 03-104/02-0023097/22 | K.HENDB.VUSHTRRIA -M | Kujtim Pllana menaxher dhe I autorizuar |
| 3 | 05.05.2022 | 03-104/02-0022666/22 | KLUBI I BOKSIT- KALAJA | Ilmi Osmani meaxher dhe I autorizuar |
| 4 | 13.05.2022 | 03-104/02-0024266/22 | K.HENDB.SAMADREXHA -F | Bekim Sopjani menaxher dhe I autorizuar |
| 5 | 12.05.2022 | 03-104/02-0023948/22 | K.HENDB. SAMADREXHA-M | Ferat Basholli menaxher dhe i autorizuar |
| 6 | 13.05.2022 | 03-104/02-0024198/22 | FUTBOLL KLUB FORCA | Enis Ternava menaxher dhe I autorizuar |
| 7 | 12.05.2022 | 03-104/02-0024053/22 | SHKOLLA E TENISIT VUSHTRRIA | Irfan Hasani Menaxher dhe I autorizuar |
| 8 | 11.05.2022 | 03-104/02-0023748/22 | SHOQATA E PEDAGOGËVE | Vllaznim Shabani menaxher dhe I autorizuar |
| 9 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022051/22 | SHOQATA SITNICA | Ramadan rashani menaxher dhe I autorizuar |
| 10 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022165/22 | K.BOKSIT VUSHTRRIA | Shefqet Hajdari menaxher dhe I autorizuar |
| 11 | 13.05.2022 | 03-104/02-0024307/22 | EVDS | Aurora Zymeri menaxher e projektit<br>Donat Zabergja I autortizuar |
| 12 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022211/22 | K.VOLEJB. AS VUSHTRRIA- F | Ramadan Parduzi menaxher dhe I autorzuar |
| 13 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022204/22 | K.VOLEJB..AS VUSHTRRIA -M | Ramadan Parduzi menaxher dhe I autorzuar |
| 14 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022120/22 | K.GJIMNASTIKËS VUSHTRRIA | Arlind Shaqiri menaxher dhe I autorizuar |
| 15 | 06.05.2022 | 03-104/02-0022897/22 | K.BASKETB. VUSHTRRIA BASKET | Arianit Morina menaxher dhe I autorizuar |
| 16 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022272/22 | K.BASKET. GJIMNAZISTI-VUSHTRRI | Safet Shalaku menaxher dhe I autorizuar |
| 17 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022280/22 | K.FUTB..VETERANËT VUSHTRRI | Agim Xhakolli-menaxher dhe I autorizuar |
| 18 | 13.05.2022 | 03-104/02-0024377/22 | K.TIFOZËVE FORCA | Refuzuar |
| 19 | 05.05.2022 | 03-104/02-0022658/22 | K.PINGP.HASAN PRISHTINA | Arxhend Ferati menaxher dhe I autorizuar |
| 20 | 06.05.2022 | 03-104/02-0022900/22 | K.BASKET.VUSHTRRIA -M+F | Ajet Gerxhaliu menaxher dhe I autorizuar |
| 21 | 06.05.2022 | 03-104/02-0022926/22 | FC.EL-CLASICO | Astrit Salihu menaxher I projektit<br>Hajrullah Dushi I autortizuar |
| 22 | 26.04.2022 | 03-104/02-0021085/22 | K.VOLEJBOLLIT.VUSHTRRIA -F | Olta kalludra menaxhere e projektit<br>Blerim Kalludra I autroizuar |
| 23 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022194/22 | K.PINGP.VUSHTRRIA -M | Petrit Drenica meaxher dhe I autorizuar |
| 24 | 04.05.2022 | 03-104/02-0022200/22 | K.PINGP.VUSHTRRIA-F | Petrit Drenica meaxher dhe I autorizuar |
| 25 | 13.05.2022 | 03-104/02-0024373/22 | Klubi Trialon | Albion Maxhuni- person I autorizuar |

**Iu dërgohet:**

1 x Anëtaren e Kuvendit
1 x Arkivit të DKRS-së

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

# Informatë
# lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
# për gjashtëmujorin re parë të vitit 2022

Shtator 2022

Këshilli komunal për siguri në bashkësi i themeluar me Udhëzimin Administrativ të MPB-së dhe MAPL-së është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve. Ky këshill ka për qëllim rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me sjelljet e dhunshme në komunitet, si dhe ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.

KKSB, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të tij, bashkëpunon me Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore, të cilat merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi, si dhe ndërtimin e besimit për jetë të qetë e të sigurt të të gjitha komuniteteve në meset ku ata jetojnë.

Në vitin 2022 janë mbajtur 2 mbledhje në gjashtëmujorin e pare, Mbledhjet në këtë këshill janë mbajtur në gjuhët zyrtare në komunë, duke qenë se përbërja e tij është shumë etnike. Mbledhjet e KKSB-së kanë qenë të hapura, ato i kanë përcjell përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, etj. Në këto mbledhje pjesëmarrja e anëtarëve të KKSB-së ka qenë e kënaqshme, dhe secili nga anëtarët e këshillit kanë diskutuar për çështjet dhe problemet për të cilat ka përfaqësuar në këtë këshill, si dhe ka dhënë kontributin në zgjidhjen e problemeve të caktuara. gjithashtu kemi pasur pothuajse çdoherë prezent organizatat ndërkombëtare KFOR-in, OSBE-në, UNMIK etj.

Në këto mbledhje janë shqyrtuar problemet e ndryshme dhe masat që duhen të merren për parandalimin dhe evitimin e tyre.
Në mbledhjen e mbajtur më 28.06.2021 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të drejtuar nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, është diskutuar për problemet që i preokupojnë qytetarët e Vushtrrisë. Ankesat e qytetarëve i parashtruan përfaqësuesit e tyre respektivisht anëtarët e KKSB-së, ku u diskutua edhe për reduktime të ujit në qytet dhe në fshatra të Vushtrrisë.

Vlen të theksohet se në aspektin e sigurisë - janë shtuar masat e sigurisë në trafik në periudha të caktuara kohore gjatë kohës kurë fëmijët shkonin në shkolle ku duhet ta kalojnë rrugën dhe gjatë sezonit veror kurë ka ekzistuar fluksi i madh i bashkatdhetarëve

Gjithashtu ka bere kontrollimin e armëmbajtjeve, ku si rezultat i këtij kontrolli janë konfiskuar një numër i armëve. Policia është angazhuar në parandalimin e gjuajtjeve me armë zjarri në ahengje të ndryshme, por fatmirësisht numri i tyre është në zvogëlim e sipër, pasi që njerëzit po vetëdijesohen.

Sipas raporteve të policisë numri më i madh i veprave penale është kundër pasurisë, pra vjedhjet dhe vjedhjet e rënda por me angazhimin e shtuar të Policisë, ky numër është dukshëm më i vogël se vitin e kaluar.

Anëtarët e KKSB-së nga radhët e komunitetit serb, turk, rom, dhe ashkali, kanë raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë brenda komuniteteve të cilat i kanë përfaqësuar, kanë prezentuar

problemet dhe kërkesat e tyre para anëtarëve të këshillit, me të cilat është njoftuar këshilli, me ç'rast janë nxjerr rekomandime për zgjidhjen e problemeve.

Komandanti i Stacionit Policor, përveç raportimit të rregullt për gjendjen e sigurisë, njëkohësisht ka raportuar për bashkëpunimin e mirë me KFOR-in, me përfaqësues të komuniteteve gjatë punës në terren, ku janë njoftuar më për së afërmi për raportet ndëretnike në vendbanimet multi etnike në Komunën e Vushtrrisë.

Përveç KKSB-së, edhe Këshillat lokale për siguri në bashkësi si KLSP që përfshin fshatrat:
Gojbulë dhe fshatrat Karaçë, Begaj, Sllatinë, Banjskë, Tërllabuq dhe Bashkësia lokale "Kalaja" në Vushtrri si dhe KLSP – Prelluzhë, ku përfshihen fshatrat (Gllavatin, Bivolak, Beçuk, Stroc, Zhilivodë, kanë funksionuar në mënyrë të rregullt.
Këto këshilla lokale, kanë mbajtur takime në të cilat janë shqyrtuar çështje me rëndësi dhe interes për komunitetin, si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.
Mirëpresim sugjerimet dhe propozimet eventuale që mund të paraqiten në rastin e shqyrtimit të kësaj informate.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA KOSOVA – OPŠTINA VUČITRN

Predsednik

# Informacije
# U vezi radom Opštinskog saveta za bezbednost zajednice
# za prvih šest meseci 2022 godine

Septembar 2022 god

Opštinski savet za bezbednost zajednica osnovan Administrativnim uputstvom Ministarstva unutrašnjih poslova i MALU je savetodavno telo za pitanja bezbednosti zajednice, sa širokim predstavljanjem svih zajednica. Ovaj savet ima za cilj podizanje svesti građana o nasilnom ponašanju u zajednici, kao i izgradnju poverenja između policije i građana, kroz izgradnju partnerstva i zajedničke inicijative za rešavanje bezbednosnih problema zajednice.

KKSB, u okviru svojih nadležnosti i odgovornosti, sarađuje sa Kosovskom policijom i centralnim institucijama, koje se bave javnom bezbednošću, u cilju stvaranja bezbednijeg okruženja u zajednici, kao i izgradnje poverenja za miran život i bezbednost svih zajednica usred kojih žive.

U 2022. godini održana su 2 sastanka u prvom polugodištu, sastanci u ovom savetu su održani na službenim jezicima opštine, pošto je njegov sastav veoma etnički. Sastanci OOBZ-a su bili otvoreni, prisustvovali su im predstavnici KFOR-a, OEBS-a itd. Na ovim sastancima učešće članova OOBZ-a je bilo zadovoljavajuće, a svaki od članova veća je raspravljao o pitanjima i problemima za koje je zastupao u ovom veću, kao i dao doprinos rešavanju određenih problema. Skoro uvek smo imali prisustvo međunarodnih organizacija KFOR, OEBS, UNMIK itd.

Na ovim sastancima razmatrani su različiti problemi i mere koje treba preduzeti za njihovo sprečavanje i izbegavanje.
Na sastanku održanom 28.06.2021.godine Opštinskog veća za bezbednost zajednica na čelu sa Predsednikom opštine Vučitrn, Xhaferom Tahiri, razgovarano je o problemima koji zabrinjavaju građane Vučitrna. Žalbe građana iznete su njihovim predstavnicima, odnosno članovima OOBZ-a, gde se razgovaralo io redukcijama vode u gradu i u selima Vučitrna.

Vredi napomenuti da su u pogledu bezbednosti – mere bezbednosti saobraćaja pojačane u određenim vremenskim periodima kada deca idu u školu gde moraju da pređu put i tokom letnje sezone kada je veliki priliv sunarodnika.

Takođe je proverio držače oružja, gde je kao rezultat ovog pregleda su konfiskuvona veći broj oružja. Policija je angažovana na sprečavanju pucnjave na raznim žurkama, ali je, na sreću, sve manje, kako ljudi postaju svesni.

Prema policijskim izveštajima, najveći broj krivičnih dela je protiv imovine, odnosno krađa i teških krađa, ali je uz pojačano zalaganje Policije ovaj broj znatno manji nego prošle godine.

Članovi KKSB iz redova srpske, turske, romske i aškalijske zajednice izveštavali su o bezbednosnoj situaciji u zajednicama koje predstavljaju, izneli svoje probleme i zahteve članovima saveta, koji su obavešteni savetu, u kom slučaju su date preporuke za rešavanje problema.

Komandir Policijske stanice je, pored redovnog izveštavanja o bezbednosnoj situaciji, izvestio i o dobroj saradnji sa KFOR-om, sa predstavnicima zajednica tokom rada na terenu, gde su se poslednji put informisali o međunacionalnim odnosima u multietničkim -etnička naselja u opštini Vučitrn.

Pored OOBZ-a, i lokalni saveti za bezbednost u zajednici kao što je LOJB koji obuhvata sela: Redovno funkcionišu Gojbule i sela Karača, Begaj, Slatina, Banjske, Terlabuće i Mesna zajednica „Kalaja“ u Vučitrnu kao i LOJB – Prilužje, koja obuhvata sela (Glavotine, Bivoljak, Bečuk, Strovce, Žilivode).
Ovi lokalni saveti su održavali sastanke na kojima su razmatrana pitanja od značaja i interesa za zajednicu, kako u pogledu bezbednosti tako iu pogledu unapređenja međuetničkih odnosa.
Predlozi su dobrodošli, sugestije i eventualne predloge koji mogu biti predstavljeni u slučaju pregleda ovih informacija.

**Ferit Idrizi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës

---

**Datë:** **05.10. 2022**

**Për: Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal**

**Propozues: Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi** ____________

**Hartues:** **Drejtoria për Shërbime Publike, Benjamin Shala** ________

**Për shqyrtim:** Propozim Vendim

---

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, Rregullores nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 41 paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës dhe Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme 01 nr. 359/19 të datës 26.12.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën __________ 2022 merr këtë:

**V E N D I M**
**PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së pa luajtshme të komunës për ofrim të shërbimeve të transportit të mjeteve motorike me auto-merimangë në territorin e komunës.

2. Në përbërje të komisionit vlerësues caktohen:

 1.1 ______________, anëtar i Kuvendit;
 1.2 ______________, anëtar i Kuvendit;
 1.3 Benjamin Shala, ekzekutivi i komunës (DSHP);
 1.4 Bajram Beqiri, ekzekutivi i komunës (përfaqësues nga DMSh);
 1.5 ______________, Shoqëria civile në nivel komunal.

2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për shërbimin e transportit me auto-merimangë në pronën e përfshirë në vendimin paraprak të kuvendit të komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

4.1 Komisionit Vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për shërbimet e transportit me auto merimangë në pronën e paluajtshme të komunës e cila është dhënë në shfrytëzim që nënkupton:

4.1.1 Njoftimin publik i cili zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit,

4.1.2 Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës dhe së paku në njërën nga mediat e shkruara dhe elektronike.

4.1.3 Njoftimi duhet të përmbaj të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e shërbimit me auto-merimangë, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit, arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave.

4.2 Pas pranimit të ofertave Komisioni Vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.

4.3 Komisioni Vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të shërbimeve të transportit me auto-merimangë.

4.4 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës si dhe të njëjtin ju dërgon palëve të përfshira në proces.

4.5 Komisioni Vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me auto-merimangë, ofertën e përzgjedhur e procedon te kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin.

4.6 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

4.7 Komisioni, për punën e tij mbanë procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit Vlerësues.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli - Latifi**
**Kryesuese e Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
Nr./Br 359/19
Nr. i fq./Br. str. -1-
Data/Datum 26.12.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës - Vushtrri**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 pika 1.1, nenit 8 pika 1.1, nenit 14 pika 1 dhe nenit 17, pika 6 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, si dhe nenit 41, paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **26 dhjetor 2019** mori këtë :

## VENDIM
## PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcela kadastrale P-70202010-00583-1 me sipërfaqe prej 10057$m^2$, ZK Bukosh, në afat prej 5 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për shërbime e transportit të automjeteve me auto-merimangë.

2. Obligohet Komisioni Vlerësues i cili do të formohet nga Kuvendi për këtë vendim-Paraprak, të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

3. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës

---

**Datë:** **10.06. 2022**

**Për:** **KPF –në dhe Kuvendin Komunal**

**Propozues:** **Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi** ________________

**Hartues:** **MAPL dhe koordinatori për sistemin e menaxhimit të performancës,**

**Islam Latifi** ________________

**Për shqyrtim: Raporti i performancës dhe grantit të bazuar në performancë për vitin 2021 për Komunën e Vushtrrisë**

---

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe me partnerët e MAPL-së, ka publikuar raportin e performancës për vitin 2021, i cili raport përmban 19 fusha dhe 104 tregues nga 119 sa janë gjithësej dhe Grantin e Performancës i cili bazohet në 28 tregues ndërsa Komunën e Vushtrrisë e ka renditur mesatarishtë, me një përqindje prej 54.39%.

Raporti përfshin periudhën janar-dhjetor 2021 dhe është tërësisht i bazuar në metodologjinë standarde dhe dokumentin kryesor të sistemit të performancës komunale, dokumente këto të diskutuara dhe të formuluara gjatë viteve të fundit, si dhe Rregulloren e Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr. 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemës së Grantit për Performancë Komunale.

Hyrja

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre për herë të dytë u realizua përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Në këtë sistem kishin qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sikurse herën e parë sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjitjes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synonte të pasqyronte dy aspekte kryesore të punës së komunave:

1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe

2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Raporti i performancës komunale prezanton rezultatet e komunave nëpërmjet 19 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre. Vitet e kaluara, Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale kaloi nëpër një proces të rishikimit të plotë, ashtu siç ishte paraparë në planin vjetor të punës së ministrisë. Objektiv i zhvillimit të sistemit ishte përfshirja e sa më shumë fushave të kompetencave komunale dhe treguesve që synonin së pari të pasqyronin gjendjen reale të ofrimit të shërbimeve publike, dhe së dyti rezultatet e fituara të shërbenin si burime të rëndësishme të të dhënave për përmirësim të qeverisjes në sektorët në nevojë.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe për të reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Për vitin 2021 kanë raportuar 37 komuna të Republikës së Kosovës[1]

Sistemi është i ndërtuar mbi tetë parime themelore:

- Parimin e ligjshmërisë;
- Parimin e transparencës;
- Parimin e subsidiaritetit;
- Parimin e meritës;
- Parimin e efikasitetit dhe efektivitetit;
- Parimin e vlefshmërisë;
- Parimin e barazisë; dhe
- Parimin e zbatueshmërisë.

---

[1] Të dhënat nuk janë raportuar nga Komuna e Skenderajt

Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve ne komuna brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.

Edhe në këtë cikël të matjes dhe vlerësimit të punës së komunave, shtrirja e të dhënave reflekton të arriturat e komunave në kuadër të treguesëve, rezultateve (nënobjektivave) dhe *fushave* sipas kompetencave vetanake përkatëse.

Sipas këtij raporti Komuna e Vushtrrisë nuk ka arritur të plotësojë kriteret minimale për të përfituar fonde nga Granti i Performancës përmes skemës së bashkëfinancuar ndërmjet donatorëve SDC/DEMOS dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Trendet e performancës së Komunës së Vushtrrisë ndër vite

Matja e performancës së komunave rezulton me të dhëna që pasqyrojnë shkallën e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ana e komunave. Ndër vite kanë ndryshuar elementet e matjes së performancës ngase numri i treguesve ka ardhur gjithnjë duke u rritur. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale.

**Informatat e përgjithshme për Komunën e Vushtrrisë**

| Komuna | Territori në $km^2$ | Numri i banorëve | Performanca % |
|---|---|---|---|
| **Vushtrri** | 345 | 69870 | 54.39 % |

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se Komuna e Vushtrrisë ka arritur performancë të shkallës mesatare (54.39%).




**Fig.1.** *Performanca e Komunës së Vushtrrisë sipas viteve 2017-2021*

Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2021 nxjerr të gjetura të shumta për 19 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

**Arritjet më të larta**

Komuna qëndron lart me performancë në fushat si vijon: fusha e shërbimeve administrative, transparenca, infrastruktura publike, mbrojtja e mjedisit lokal, në menaxhimin e mbeturinave,. Ndërsa në nivel të mesëm të ofrimit të shërbimeve, Komuna e Vushtrrisë i ka këto shërbime:, mirëqenia sociale dhe familjare, kultura rinia dhe sporti, fusha e transportit publik, parkingjet publike, uji i pijshëm, kanalizimi, dhe fusha për planifikim urban.

**Arritjet më të ulëta sipas treguesve**

Komuna ka shënuar performancë të ulët sipas treguesve në vijim: % e të punësuarve me aftësi të kufizuar në institucionet komunale, sipas përkatësisë gjinore, sipërfaqja e shesheve publike në m2 për kokë banori, sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banori, % e të punësuarve nga komunitetet joshumicë sipas përkatësisë gjinore, % e vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza, % e popullatës e cila përfiton nga skema sociale, hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë $m^2$/kokë banori, etj.

**Rekomandim**

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike, si dhe gjetjeve nga ky hulumtim, Komunës së Vushtrrisë i rekomandohet që të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrej tonline
- Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët
- Sa më shumë përfshirje të punësuarve me aftësi të kufizuara, si dhe sipas përkatësisë gjinore, në institucionet komunale;
- Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal
- Ligjshmëria e kontratave për shërbime të veçanta;
- Rritjen e sipërfaqeve, shesheve publike në m2 për kokë banori;
- Rritjen e sipërfaqeve të hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banori;
- Përfshirje të punësuarve nga komunitetet joshumicë sipas përkatësisë gjinore;
- Rritja e % së vendbanimeve për furnizim me ujë të pijshëm;
- Vlerësimi vjetor i punëtorëve - shërbyesve civil, në bazë të udhëzimit për vlerësim;
- Rritjen e % të vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza;
- Rregullimi i numrit të popullatës e cila përfiton nga skema sociale.
- Hartimi i Planit Lokal për Veprim në Mjedis,
- Diskutimi në kuvend i Raportit të auditorit të brendshëm,
- Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal,
- Përmbushja e standardeve minimale të konsultimeve publike,
- Miratimi me kohë i buxhetit vjetor,
- Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit,
- Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme),
- Konstituimi i Këshillave të vendbanimeve-fshatrave,

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur vlerësimi i kushteve minimale për vitn 2021:

Nga vlerësimi shihet se Komuna e Vushtrrisë nga katër kushtet minimale, i ka përmbushur vetëm dy, përderisa dy kushtet tjera; Raporti i auditorit duke qenë i kualifikuar dhe shpenzimi i buxhetit për investime kapitale për vitin 2021 në vlerën më pak se 75 %, nuk janë përmbushur dhe rrjedhimishtë Komuna e Vushtrrisë nuk është pjesë e Grantit të Performancës për vitin 2021.

**Vlerësimi i kushteve minimale për vitit2021 për grantin e performancës komunale- KomunaVushtrri**

| | Kushti minimal | Udhëzimet për vlerësim | Vlera sipas burimit | Vlerësimi | Burimi Te Dhenave | Vrojtimet (në qoftë se ka) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar; | PO, në qoftë se komuna ka raportuar në SMPK në afat të përcaktuar. JO, në qoftë se komuna ka rapotuar në SMPK pas afatit të përcaktuar. | | Po | Raporti SMPK 2020 | |
| 2 | Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoritet mbikëqyrës | PO, në qoftë se komuna ka rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikqyrëse sipas kërkesave ligjore. JO, në qoftë se komuna nuk ka rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikqyrëse sipas kërkesave ligjore. | | Po | Raporti i funksionimit te komunave 2020 | |
| 3 | Opinioni i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; | PO, në qoftë se komuna merr: 1) opinion të pamodifikuar, ose 2) opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes JO, në qoftë se komuna merr: 3) opinion të kualifikuar 4) opinion të kualifikuar me theksim të çështjes 5) opinion të kundërt, ose 6) ZKA refuzon të japë opinion | | Jo | Raporti vjetor i auditimit te komunes 2021 | |
| 4 | Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale | PO, në qoftë se komuna ka shpenzuar së paku 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale JO, në qoftë se komuna ka shpenzuar më pak se 75% të buxhetit final për investime kapitale | | Jo | Raporti vjetori i auditimit dhe shkresa e MFTP | 68.03% |

Fig. 2. Vlerësimi i kushteve minimale për grantin e performancës komunale për vitin 2021

Linku: https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
**Komuna Vushtrri**
Opstina Vucitrn / Municipality of Vushtrri

**Drejtoria për Shërbime Publike**

Propozues, Kryetari i Komunës ____________________
Hartues, Drejtoria për Shërbime Publike ____________________
**Çështja për shqyrtim, Propozim vendim për lirim nga taksa komunale për prerje të asfaltit.**

Në bazë të nenit 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 2 dhe neni 8 të Ligjit nr 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi1.4. të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01. Nr. 209/2022, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më__________ mori këtë :

**V E N D I M**
***Për lirim nga taksa komunale për projektet investive të KEDS-it gjatë vitit 2022***

1. Me këtë vendim lirohet nga taksa komunale për prerje të asfaltit dhe demolim të kubëzave Divizioni i Shpërndarjes KEDS i cili është duke i implementuar Projektet me plan Investiv 2021 në Komunën e Vushtrrisë si në vijim:

   *1.1. Projekti „TS Idrizi'' fsh.Dobërllukë ,Ndërtimi rrjetit TM10(20)kv dhe TU0.4Kv*

   *1.2. Projekti „Dobërllukë(Bajska) , zgjerim dhe përforcim I rrjetit Distributiv*

   *1.3. Projekti „Stanovci 1 Prekazët'', fsh.Stanoc Poshtëm , Komuna e Vushtrrisë zgjerim dhe përforcim I rrjetit Distributiv*

   *1.4. Projekti „Bregaj Stanovc'',fsh.Stanoc i Epërm, Komuna e Vushtrrisë , zgjerim dhe përforcim i rrjetit Distributiv*

2. Këto projekte kanë për qëllim riparimin e rrjetit elektrik dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike në komunën tone.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Inspektime.

4. Ky vendim hyn ne fuqi 15 dite pas regjistrimit ne zyren e protokollit te Ministrise per Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit ne faqen zyrtare të Komunës se Vushtrrisë.

**A r s y e t i m**

Drejtoria për Shërbime Publike pas shqyrtimit të kërkesës me nr. Protokoli 11/104/02-0047726/22 e dates 13/09/2022 parashtruar nga Departameni i Investimeve KEDS për prerje të asfaltit për punime në rrugë, e që ka të bëjë lidhur me realizimin e projekteve investive 2021 për Komunën e Vushtrrisë konstatoi:
Duke u bazuar në Pëlqimet e lëshuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si Pëlqimin 08Nr.590/21 e dt.25/10/2021; Pëlqimin 08Nr.592/21 e dt. 25/10/2021;Pëlqimin 594/21 e dt.25/10/2021dhe Pëlqimin 595/21 e dt.25/10/2021 me të cilat Departamentit Investiv i Divizionit Shpërndarës KEDS me Përfaqsues Burbuqe Baruti i lejohet zgjerim dhe përforcim i rrjetit Distributiv si dhe duke u nisur nga vetë fakti se po të bazohemi në nenin 6.paragrafi 8 lidhur me nënparagrafin 8.5 të Rregullores 278/15 për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale ku citohet : ***Me rastin e zëvëndësimit të rrjetit elektrik ajror me rrjetin elektrik nëntoksor , Operatori lirohet nga taksa administrative*** .
Andaj nga ajo që u cekë edhe më lartë kërkojmë që operatori në fjalë të lirohet nga taksa administrative për prerje të asfaltit, sepse në gjë e tillë do të përmirësoj dukshëm dhe në mënyrë kualitative furnizimin me energji elektrike për qytetarët (konsumatoret) në fshatrat përfshirë në projektet e listuera në dispozitivin e këtij vendimi.

- *Sipërfaqja e cila do të gërmohet për hapje të kanalit për kalim të kabllove, në bazë të kalkulimeve është 51.50 m$^2$* .
- *Taksa komunale për prerje të asfaltit është 50 €/m$^2$ dhe taksa me të cilën është ngarkuar KEDS është 2,560.00 €.*

Në bazë të cekurave më lartë i propozojmë për aprovim anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë këtë propozim vendim si në dispozitiv.

**Drejtori i drejtorisë**

**Benjamin SHALA**

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

**Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës**

**Propozues: Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës**

**Hartues: Medina Bunjaku, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport**

**Lënda: Propozim-vendim**

Bazuar në nenin 13.1. pika ''a'' të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr.02/L-26, nenit 12.2 ''d'', 14 .1 dhe 17 ''c'' lidhur me pikën ''s'' të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 ''ç '' të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më ________ **2022** mori këtë:

**VENDIM**

**Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë**

**Neni 1**

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e lapidarit në fshatit Pasomë pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m2, nga sipërfaqja të përgjithshme prej 89886 m2, me kulturë kullosë e kl.4 ZK P e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2**

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të patundshmërisë të cekur në neni 1 të këtij vendimi, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destiminit (kulturës) së kësaj parcele në elaboratin kadastral.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendim obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

______________________

**Melihate Basholli**

**A r s y e t i m**

Banorët e fshatit Pasomë, përmes përfaqësuesit të tyre në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, z. Ali Januzi, i kanë paraqitur kërkesë kryetarit të komunës për mundësinë e ndërtimit të një lapidari në fshatin Pasomë, por edhe sigurimin një parcele kadastrale, në të ciliën do të ndërtohej lapidari në nderim të patriotit shqiptar Adem Voca, në fshatin Pasomë.
Pas shqyrtimit të kërkesave, në buxhetin e Komunës së Vushtrrisë është planifikuar ndërtimi i lapidarit dhe është identifikuar vendi ku do të mund të ndërtohej ai lapidar, pasi që prona në të cilën është propozuar nga banorët por edhe nga ekipi i zyrtarëve komunalë që kanë dalë në terren për të parë vendin e propozuar është pronë e Komunës së Vushtrrisë, në zonën kadastrale në Pasomë.
Duke vlerësuar se në atë vend kishte qenë më herët edhe kulla e patriotit shqiptar Adem Voca, edhe komisioni i caktuar nga komuna e Vushtrrisë për vlerësimin e atij vendi ka mbështetur propozimin dhe ka bashkëngjitur edhe dokumentet e nevojshme që anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, të kenë mundësinë t'i shohin.

Prandaj Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kërkon nga Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që ta mbështesë këtë propozim-vendim, me të cilin nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 89886 m2, me kulturë kullosë e kl.4 ZK P e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë, sipërfaqja prej 613 m2 caktohet për ndërtimin e lapidarit për Adem Vocën.

*Bashkangjitur me këtë propozim-vendim, keni dokumentet dhe shkresat e nevojshme për çështje në fjalë:*
*- certifikatën e pronës*
*- kopjen e planit*
*- dy fotografi të pjesës së parcelës që planifikohet për ndërtim të lapidarit*

**Drejtoreshë e DKRS-së**

**Medina Bunjaku**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

18/3780

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202050-01296-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 18-3780/22 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 30.09.2022 - 10:48 |
| Komuna / Opština / Municipality: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Pasomë / Pasomë / Pasomë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70202050-01296-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 89886 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SUVI BREG | | | | |

P.intuar nga / Odštampani od / Printed by: Valon.Maxhuni | P-70202050-01296-0 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | **89886** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Vushtrrisë** | 600535001 | VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI / | | AHMET KRASNIQI | **1/1** | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

181 5780

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pasomë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70202050-01296-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 89886 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:6016

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 30.09.2022

Koha/ Vreme/ Time: 10:51:55

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkhrimi/Potpis/Signature:

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR
UPRAVA ZA GEODEZIJU I KATASTAR
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVO


947-0
314-0
20.5m
30.00m
S-613m2
20.5m


Wireframe]
954-0
955-0
947-0
1313-0
1312-0
1314-0
1311-0
1310-0
1207-0
1296-0
1309-0
1308-0
1303-0
1304-0
1317-0
1338-0
1339-0
1343-0
1354-0
1359-0